

asi

ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE
NEWSLETTER

SHKURT 2007, Nr. 26



Ekipi i Unitetit i raporton Kuvendit

Komisioni hetimor

Intervistë me z. Naim Malokun,
kryetar i komisionit të Kuvendit për siguri

EDITORIAL



Më 2 shkurt 2007, Kryenegociatori Martii Ahtisaari, i Dërguari Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për procesin e ardhshëm të statusit të Kosovës, ka paraqitur propozimin e tij gjithëpërfshirës. Prezentimi i propozimit dhe konsultimet që pasojnë lidhur me tekstin paraqesin fazën finale të procesit të definimit të statusit të Kosovës përpara marrjes së vendimit nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

Me përgatitjet e Kosovës për statusin e saj të ardhshëm, kanë filluar edhe përgatitjet e vëmendshme për periudhën katër mujore të tranzicionit gjatë së cilës institucionet e Kosovës do të marrim përsipër më shumë kompetenca, përgjegjësi dhe obligime, ndërkohë që Zyra Civile Ndërkombëtare e udhëhequr nga BE do të mbikëqyrë implementimin e zgjidhjes: 'Kjo sfidë e dyfishtë administrative dhe politike tejkalon të gjitha që Kosova ndonjëherë do të ketë menaxhuar', ka theksuar Z. Torbjorn Sohlstrom, përfaqësuesi personal i z. Sollanës, Koordinator i BE-së për Punë të Jashtme dhe Kryesues i Ekipit Përgatitor të Zyrës të Komunitetit Ndërkombëtar/Përfaqësuesi Special i Europës për Kosovën.

Të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë marrë tekstin e plotë të "Pakos së Ahtisaarit" dhe kanë debatuar mbi të brenda të partive të tyre politike dhe në Kuvend. Propozimi përmban dispozitat e detajizuara mbi të drejtat e komuniteteve minoritare, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, decentralizimin dhe çështje tjera të ndërlidhura me statusin e ardhshëm të Kosovës.

Ndikim të menjëhershëm në funksionimin e Kuvendit do të ketë "Shtojca 12", që ka të bëjë me agjendën legjislative për periudhën e tranzicionit pas miratimit të rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Relevante për punën e Kuvendit është edhe "Shtojca 1" mbi dispozitat kushtetuese që parasheh përgatitjen e parakushteve për krijimin e "Komisionit Kushtetues" që do të draftojë kushtetutën e cila do të miratohet më pas nga Kuvendi.

Se në ç'mënyrë do të të funksionojë Kuvendi i Kosovës gjatë muajve të ardhshëm do të varet nga prioritetizimi i punëve në Kuvend, arritja e koncensusit politik dhe planifikimi adekuat i kuadrove shtesë.

Ky edicion i Buletinit të ASI-t i adresohet çështjeve kyçe të fuqizimit të kapaciteteve legjislative të Kuvendit, procesit të krijimit të politikave dhe implementimit të ligjeve. Në këtë botim mund të gjeni informacionet mbi zhvillimet më të rëndësishme në Kuvend gjatë muajve dhjetor 2006 dhe janar 2007. Gjithashtu edhe vlerësimet e deputetëve për punën e arritur në Kuvend gjatë dy muajve të fundit. Buletini gjithashtu përmban një pasqyrë të programeve më të reja të mbështetjes punës në Kuvend. Mbetemi me shpresë që informacionet të jetë të dobishme për punën tuaj!

*Franklin De Vrieze,
Koordinator i Iniciativës për Mbështetje Kuvendit.*

Editoriali	2
Koha për votim të hapur	3
Kryetari i Kuvendit, z. Berisha, i drejtohet deputetëve në seancën e parë për vitin 2007	4
Kuvendit do t'i duhet ta miratojë legjislacionin për implementimin e statusit, dhe njëkohësisht të vazhdojë me punët e tanishme	5
Komisioni hetimor: përvojë e re në ndërtimin e institucioneve shtetërore	6
Kuvendi duhet ta ketë rolin e vet në ndërtimin e mekanizmave të sigurisë	7
Evropa e Bashkuar duhet të udhëheqë në zgjidhjen e çështjes së Kosovës	9
Nga Kapitol Hill në Kosovë	10
Buxheti i Kosovës dhe sfidat e së ardhmes së afërt	11
Zhvillimet e fundit në Kuvendin e Kosovës gjatë muajve: dhjetori 2006 dhe janar 2007	12
Udhëzimet trasojnë rrugën për hartimin e legjislacionit	14
Projekt aktet ligjore pa politika legjislative dhe pa vlerësime paraprake, një forme e ndikimit të nivelin e ulët të sundimit të ligjit në Kosovë	16
Ligjet pa politika	18
Transparenca: Përmirësimi i procedurave parlamentare dhe informimi i deputetëve	19
Rrugë e gjatë deri në emërimin e Ombudspersonit	21
Përkrahja për Kuvendin e Kosovës gjatë muajve: dhjetor 2006 dhe janar 2007	22



Koha për votim të hapur

Kolë M. Berisha, Kryetar i Kuvendit të Kosovës

Votë e hapur apo votë sekrete? Cila është më e dobishme, cila është më demokratike? Kjo pyetje – dilemë, ka kohë që është bërë pjesë e debateve, madje jo pak të nxehta, në qarqet politike, intelektuale, në mesin e studiuesve dhe praktikantëve të politikës. Kjo temë është aktuale sidomos në shoqëritë dhe në vendet në transicion, ndoshta për shkak të sentimenteve për rëndësinë e votës sekrete në kohëra totalitare, kur gjithë shpresat vareshin te forma e tillë, sekrete, e deklarimit kundër.

Por, kohërat kanë ndryshuar, duhet të ndryshojnë edhe qasjet tona, pra, nëse duhet, edhe mënyra e votimit. Që në fillim dua të them se, ky shkrim ka për qëllim që ta provokojë mendimin kompetent lidhur me këtë çështje, e cila, për rrethanat të cilat po krijohen edhe te ne në Kosovë, do të jetë e pashmangshme. Edhe në praktikën tonë parlamentare, në një mënyrë ose në një tjetër, do të ndeshemi me këtë çështje.

Në të vërtetë, fjala është për atë se, në institucionet tona, respektivisht në organet e tyre vendimmarrëse, me rastin e hartimit dhe të miratimit të akteve ligjore dhe të atyre nënligjore, në radhë të parë hartuesit, por edhe implementuesit e tyre në praktikë, gjithnjë e më tepër do të gjenden para dilemës se cila formë e votimit (e fshehtë apo ajo e hapur) është më demokratike. Vlen të theksohet se, krahas Austrisë, si njëra ndër vendet me një traditë më demokratike, në shumë shtete



të cilat kanë kaluar nëpër fazën e transicionit, institucionit të votës së hapur i është dhënë më shumë hapësirë. P.sh., në nenin 53.1 të aktit normativ që rregullon punën e Kuvendit Kombëtar të Bullgarisë, thuhet: “Kuvendi Kombëtar mund të vendosë që, për një çështje të caktuar, të aplikohet votimi i fshehtë”. Pra, akti në fjalë, formën e deklarimit për çështje të caktuara nuk e cakton paraprakisht, por atë ia lë në kompetencë Kuvendit që të vendosë. Madje-madje, në paragrafin 2, pika 2 dhe 5, të të njëjtit nen, shprehimisht thuhet:

“Votat e hapura bëhen me

ngritje të dorës, dhe një nga një duke e shfrytëzuar sistemin elektronik ku emrat e anëtarëve dhe votat transmetohen në ekran përmes sistemit elektronik të votimit”. Zgjidhje të njëjtë ka edhe Republika Çeke, me dispozitën 76.2, ku thuhet: “Pajisjet për votim do të shtypin rezultatin e votimit, i cili do të jenë indikator i asaj se si ka votuar secili deputet”, pastaj Polonia (neni 188, pjesa 2, kapitulli 3), etj.

Megjithatë, pavarësisht nga këto praktika, unë mendoj se, para se të përcaktohem për njërën apo për formën tjetër të votimit, duhet t’i vëmë në spikamë të metat dhe përparësitë

e njërës dhe të formës tjetër.

Praktika e deritashme ka treguar që është e pakontestueshme se, pas formës së votimit të fshehtë, në radhë të parë, fshihet:

a) Votuesi, i cili nuk e ka guximin as qytetar, as njerëzor, e aq më pak atë intelektual, që të dëshmojë haptas përcaktimin e tij, përkatësisht të subjektit të cilit i takon, për çështjen që vihet në votim; ai që nuk është i gatshëm të përballet me presionet e mundshme që vijnë nga grupe të ndryshme të interesit; ai që dëshiron “të mbetet mik me secilin”, që nuk do “të priset me askënd” dhe, secilit kandidat veç e veç, apo për cilëndo alternativë që vihet në votim, thotë se “ty ta kam dhënë votën”, apo “për propozimin – alternativën tënde kam votuar”, etj; dhe,

b) Votuesi i pandërgjegjshëm, që, duke e keqpërdorur besimin të cilin ia ka dhënë elektorati, votën e tij përherë e vë në shërbim të interesave të tij personale ose të kalkulimeve grupore, klanore, ideologjike, fetare, racore, gjinore, lokaliste-krahinore, etj., por asnjëherë, ose shumë rrallë, në dobi të elektoratit të tij, të partisë të cilës “juridikisht” i takon, të atij që ia ka dhënë besimin.

Asnjërin nga këto dy kategori votuesish, elektorati, përkatësisht subjekti të cilin e përfaqë-

sojë, nuk mund ta kontrollojë. Ai kurrë nuk mund të dijë se interesat e kujt i mbrojnë këta votues, politikën e cilit subjekt politik realisht e përfaqësojnë, programin e kujt e realizojnë.

Ndërkaq, me votimin e hapur, votuesi, në radhë të parë dëshmon besnikërinë dhe sinqeritetin e tij ndaj elektoratit ose subjektit të cilit i takon; dëshmon guximin e tij qytetar, njerëzor dhe atë intelektual për t'i shprehur haptas përcaktimet e tij, përkatësisht të elektoratit të tij, për çështje të caktuara. Kjo formë e votimit ia mundëson edhe elektoratit që ta kontrollojë përfaqësuesin të cilit ia ka dhënë votën.

Votuesi, elektorati, pra qytetari, e di saktësisht se si ka votuar përfaqësuesi i tij, kurse, në anën tjetër, deputeti apo votuesi tjetër, do të jetë më aktiv, më i përgjegjshëm dhe më efikas, sepse nuk do të mund të fshihet prapa shablloneve, por do të mbrojë votën e tij. Kjo do të thotë se ai vazhdimisht duhet të jetë transparent dhe ky është një nga kualitetet e dëshirueshme të demokracisë.

Në një analizë të argumenteve pro ose kundër votës së hapur, duket qartazi se favoret nga vota e hapur janë shumë më të mëdha. Pa dyshim, vetë praktikat e votimit të këtu në vendet me demokraci të zhvilluar e të konsoliduar janë verifikimi më i fuqishëm i këtij konstatimi. Pse të mos i ndjekim edhe në këtë model.

Në favoret e demokracisë, mbase do të duhej të ngutemi ngadalë. Latinët do të thoshin

“Festina lente

Kryetari i Kuvendit, z. Berisha, i drejtohet deputetëve në seancën e parë për vitin 2007

Kolegë të nderuar,

Nuk kam për qëllim që tek ju të ngjall shqetësim lidhur me proceset që i kemi përpara. Jo. Por, ajo që kërkohet prej nesh është punë me përgjegjësi, ndërgjegjësimi dhe koshienca jonë për proceset. Nëse të tjerët flenë edhe ditën, ne nuk do të duhej të flemë as natën. Çështja, pra, sa është motivuese e emocionuese, është po aq edhe serioze.

Së këndejmi, dua t'ju them se, gjatë muajve në vijim, ky Kuvend do të përballet me sfida ndër më ndryshmet dhe ndër më të rëndat. Ky Kuvend do të marrë vendime, ndoshta shumë të vështira, vendime që do ta përcaktojnë dhe do ta definojnë qartë fatin e Kosovës, fatin e fëmijëve tanë dhe të fëmijëve të fëmijëve tanë.

Dua të tërheq vërejtjen se, ky Kuvend, shumë shpejt, ndoshta që në seancën e ardhshme, pas konsultimeve dhe harmonizimit të qëndrimeve ndërmjet të subjekteve politike, në procedurë të rregullt kushtetuese, do t'i përcaktojë kriteret dhe do të marrë vendim për miratimin e Këshillit Kushtetues, i cili do ta hartojë Kushtetutën e re, Kushtetutën e parë të Kosovës së pavarur.

Dua të vë në spikamë se ky Kuvend, po ashtu, shumë shpejt, do të përballet me çështjen e simboleve siç janë: Flamuri, Himni dhe simbolet e tjera të shtetit të ardhshëm të Kosovës.

Shumë shpejt do ta kemi para nesh, për shqyrtim, të ashtuquajturën “Paketë e Marti Ahtisarit” dhe jemi ne, në këtë Kuvend, ata që, asaj pakoje, duhet t'i japim përgjigjen e duhur.

Ky Kuvend, shumë shpejt do t'i ketë para vetes për shqyrtim dhe miratim, një numër të madh projektligjesh dhe aktesh të tjera nënligjore, me të cilat, do të rregullohen fusha të ndryshme të jetës, tani, në rrethana të reja, në një Kosovë të pavarur dhe sovranë. Pra Komisionet duhet të jenë shumë më azhure. Por, të gjitha këto detyra, sado që na duken të rënda, ne do t'i përmbushim me lehtësi nëse vërtet jemi unikë, nëse vërtet jemi të përgjegjshëm, nëse vërtet e duam këtë vend, e duam këtë tokë, siç po deklarohe mi çdo ditë. Por, po ashtu, në rast nevojë, ky Kuvend, pas konsultimeve paraprake, do të dijë që, me kohë dhe me mjete të duhura, të veprojë në harmoni me rolin, kompetencat dhe mandatin që e ka marrë nga populli.

Andaj, kolegë të nderuar deputetë, kryeministër Çeku, zëvendëskryeministër Haziri, ministra dhe zëvendësministra të Qeverisë së Kosovës, njerëz të këtij vendi të shtrenjtë e të shenjtë, ju thërras, jo vetëm si kryetar i Parlamentit të Kosovës, dhe jo vetëm si koleg, si mik dhe si bashkëqytetar i juaji, por, ju lus që, deri sa të përfundojë procesi i definimit të statusit të Kosovës,

derisa bëjmë Kushtetutën tonë, derisa duhet t'i mbajmë zgjedhjet e para lokale dhe nacionale, dhe ta formojmë qeverinë e parë në Kosovën e pavarur, t'i lëmë me një anë kundërthëniet e çastit, t'i lëmë me një anë interesat e ngushta partiake, klanore, ideologjike, farefisnore, etj., (të cilat, në të tjera rrethana, do të ishin krejt normale). Më lejoni të përsëris konstatimin që e dua shumë: janë 99 fije që na bashkojnë dhe vetëm një, madje edhe ajo shumë e hollë, që na ndan.

Prandaj, ju ftoj që të gjithë së bashku, pozitë dhe opozitë, shumicë dhe pakicë, të jemi në nivel të përgjegjësisë që kemi; të jemi unikë në vendimarrje; të jemi të përgjegjshëm për rolin historik që kemi. Në emër të të gjitha këtyre që u thanë dhe të shumë të tjerave që nuk u thanë, në emër të të sotmes dhe të nesërme, uroj që të kemi vit të suksesshëm e punë të mbarë.

Prishtinë, 11 janar 2007



“Kuvendit do t’i duhet ta miratojë legjislacionin për implementimin e statusit, dhe njëkohësisht të vazhdojë me punët e tanishme”

Ambasadori Werner Wnendt, Shefi i Misionit të OSBE-së në Kosovë



Viti 2007 sigurisht që do të jetë vit i rëndësishëm për Kosovën. Nën hijen e zgjidhjes së statusit të ardhshëm, ndërrimit të karakterit të prezencës së Bashkësisë Ndërkombëtare dhe një zhvillimi të përshpejtuar drejt integritimit evropian dhe implementimit të Standardeve Europiane (të cilat gjithashtu janë Standarde Europiane), Kosova vazhdon të përballlet me sfida dhe mundësi të reja.

Ajo çfarë shumica e shohin të jetë sfida kryesore në të ardhmen është zgjidhja e statusit dhe e tërë puna që ndërlihet me të. Çështja e së ardhmes së Kosovës është në qendër të vëmendjes në Vjenë, Bruksel, Nju Jork dhe shumë kryeqendra tjera. Ne presim që zgjid-

hja të sjellë një vizion të qëndrueshëm dhe të zbatueshëm për të ardhmen e Kosovës. Po kompromisi kërkon që të ketë konsultime politike si në nivelin nacional ashtu edhe atë ndërkombëtar. Gjithë populli i Kosovës – politikanët dhe shoqëria në tërësi – duhet të jenë të përkushtuar ndaj vlerave të demokracisë dhe tolerancës, meqë ato trasojnë rrugën e stabilitetit shoqëror, zhvillimit ekonomik dhe integritit në sistemin ndërkombëtar.

Një tjetër detyrë për Kosovën, krahas implementimit të pakos për statusin, është edhe procesi i tranzicionit. Ndonëse, për format e prezencës së ardhshme ndërkombëtare dhe bartjen e kompetencave akoma duhet diskutuar, pritet që përgjegjësia kryesore për të ardhmen e Kosovës të bartet tek IPVQ. Bashkësia Ndërkombëtare do të vazhdojë të qëndrojë. Pritet gjithashtu që të përforcohet roli i Bashkësisë Europiane dhe lidhjet e Kosovës me të. Kosova është një prej prioriteteve të Kryesisë aktuale të BE-së. BE për momentin është duke vazhduar me përgatitjet për pozicionimin e Zyrës Civile Ndërkombëtare dhe Misionit për Kosovë të Politikave për Mbrojtje dhe Siguri (ESDP).

E ardhmja e Kosovës dhe zhvillimi i institucioneve demokratike janë çështjet prioritare në Kryesimin aktual të

OSBE-së. Objektiva jonë është që të sigurojmë që Kosova të vazhdojë rrugëtimin e saj drejt një shoqërie demokratike dhe të zhvilluar, e cila ofron mundësi të barabarta për të gjithë. Misioni i OSBE-së në Kosovë do të vazhdojë me rolin e tij mbështetës në krijimin e kushteve të cilat do të ndihmojnë përfundimin dhe implementimin e zgjidhjes së statusit të ardhshëm.

Aktivitetet tona për ngritjen e institucioneve do të përqendrohen kryesisht në qeverisjen e mirë, duke mbështetur institucionet e pushtetit qendrorë dhe lokal. Gjithashtu duhet të vazhdojmë me përpjekjet për ngritjen e kushteve pozitive për zhvillimin e një shoqërie multi-etnike dhe sundimin e ligjit. Ky Mision do të përqendrohet në ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e njerëzve që të marrin pjesë aktive në qeverisje. Prezenca jonë në terren është një mekanizëm i rëndësishëm për të siguruar që të arrijmë tek të gjitha komunitetet në Kosovë dhe të ofrojmë ndihmë në të gjitha nivelet e pushtetit.

Një prej iniciativave të suksesshme të OSBE-së që synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e elitave politike në Kosovë, është edhe Iniciativa për Mbështetje Kuvendit-ASI. Në fund të këtij viti, mandati tre vjeçar i Kuvendit të Kosovës do të përfundojë

dhe sipas legjislacionit aktual, duhet të mbahen zgjedhjet parlamentare. Deri atëherë, Kosovës do t’i nevojitet një sërë ligjesh dhe rregulloresh për zgjedhjet, si dhe përgatitjet e duhura teknike që kanë të bëjnë me organizimin e zgjedhjeve. Aktualisht, mandati i vitit 2007 në Kuvend, do të jetë më i rëndësishmi dhe më sfiduesi. Kjo do të jetë evidente posaçërisht në disa muajt e ardhshëm, kur zgjidhja e statusit të jetë dorëzuar. Kuvendi do të duhet të miratojë legjislacionin për implementimin e statusit, dhe njëkohësisht të vazhdojë me punët e tanishme. OSBE dhe partnerët e saj të ASI-t do të vazhdojnë të mbështesin Kuvendin në përgjegjësitë e tij për të shërbyer popullin e Kosovës. Disa prej këtyre aktiviteteve përfshijnë bashkëpunimin e shtuar me legjislativët tjerë rajonal dhe evropian, marrëdhënie të shtuara me partitë politike të Europës dhe harmonizim të vazhdueshëm të ligjeve të Kosovës me standartet e BE-së.

Përkundër shumë sfidave me të cilat ballafaqohemi, shpresoj që viti 2007 të jetë një vit i suksesshëm për Kosovën dhe popullin e saj. OSBE qëndron e gatshme të ofrojë vazhdimësi, ekspertizë dhe asistencë për të siguruar që Kosova vazhdon të ecën në rrugën e saj drejt një shoqërie multi-etnike, moderne dhe demokratike.

Komisioni hetimor: përvojë e re në ndërtimin e institucioneve shtetërore

Dr. Ferid Agani,

Kryetar i Komisionit hetimor të Kuvendit të Kosovës, deputet i Partisë së Drejtësisë, anëtar i Grupit parlamentar "Për Integrim"



Me 3 Nëntor 2006, Kuvendi i Kosovës ngriti Komisionin Hetimor për të gjeturat faktike në Kuvend nga Raporti i Auditorit të Përgjithshëm të Kosovës. Të gjeturat faktike nga ky Raport indikojnë mangësi serioze në punën e organeve më të larta të Kuvendit.

Në pajtim me Rregulloren e punës së Kuvendit, Komisioni hetimor përbëhet nga katërmëdhjetë anëtarë, që reflektojnë raportin e forcave politike brenda Kuvendit të Kosovës. Mbledhja themeluese e Komisionit u mbajtë me 13 Nëntor 2006. Puna e Komisionit hetimor u mbështet nga: Kuvendi i Kosovës, OSBE, NDI përfshirë USAID, si dhe Projekti mbështetës për Kuvendin e Kosovës i AER.

Që në fillim të punës Komisioni u ballafaqua me mungesën e evidencave të ligjta për

procedurat hetimore parlamentare. Si rezultat, Komisioni hetimor nuk dispononte me fuqinë ligjore të detyrimit të individëve relevant për t'u paraqitë para Komisionit me qëllim të dhënjes së dëshmisë.

Rrethanë tjetër vështirësuese ishte zhvillimi paralel i procedurës penale hetimore pranë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, ndaj katër zyrtarëve të Kuvendit të Kosovës. Ky fakt imponoi nevojën e kujdesit, që Komisioni hetimor të mos ndërhyjë në procesin e procedurave gjyqësore.

Kuvendi i Kosovës kishte mungesë evidente të përvojës me procedura hetimore parlamentare; dy Komisionet hetimore të ngritura në mandatin paraprak të Kuvendit nuk e kishin përfunduar punën e tyre. Kjo imponoi nevojën që Komisioni hetimor, fillimisht të merret me përpilimin e dokumenteve themelore mbi të cilat do të zhvillonte aktivitetin e tij.

Pas përpilimit dhe miratimit të Rregullores së punës dhe të Planit të punës me dinamikën kohore të veprimit, Komisioni identifikoi objektivat e tij dhe përcaktoi kornizën metodologjike për realizimin e tyre. U vendos që procedurat hetimore ndaj zyrtarëve relevant, të realizohen nëpërmjet ftesave për dhënjen e përgjegjeve me shkrim në pyetje të caktuara dhe ftesave për dëshmi gojore lidhur me

çështjet që do të mbeteshin të pasqaruara. Për këtë qëllim u përpiluan formularët e ftesës për dhënjen e deklaratës me shkrim, formulari i ftesës për dhënjen e dëshmisë gojore si dhe udhëzimet për anëtarët e Komisionit për pjesëmarrje në seancën dëgjimore.

Punën e Komisionit hetimor në vazhdimësi e mbështeti sekretariati administrativ i caktuar nga administrata e Kuvendit.

Pas identifikimit të listës së zyrtarëve relevant si dhe përcaktimit të pyetjeve kryesore për ta, seanca e parë dëgjimore u realizua me 24 Nëntor ndërsa ftesat e para për dhënjen e deklaratave me shkrim u dërguan me 06. Dhjetor 2006. Shumica e zyrtarëve i'u përgjegjen ftesës në mënyrë adekuate dhe brenda afatit të përcaktuar kohor. Komisioni i vazhdoi punimet me shqyrtimin e përgjegjeve të arritura si dhe me dërgimin e ftesave të reja për përgjegje me shkrim ose për dëshmi gojore.

Në mbledhjen e 16 Janarit 2007, Komisioni hetimor e miratoi kornizën e draftit të raportit përfundimtar si dhe vendosi për organizimin e dy seancave dëgjimore deri në fund të punës së tij. Përveç seancës dëgjimore me Auditorin e Përgjithshme të Kosovës, që ishte e mbyllur për opinion, puna e Komisionit hetimor gjatë tërë rrjedhës së saj ishte e hapur.

Punën e Komisionit hetimor e kanë cilësuar debatet e hapura dhe konstruktive si dhe fryma e plotë konsensuale gjatë marrjes së vendimeve.

Në bazë të dinamikës së përcaktuar të punës Komisioni hetimor do ta dorëzojë Raportin përfundimtarë me konkluzat dhe rekomandimet përkatëse për Kuvendin e Kosovës, deri me 31 Janar 2007.

Shpresoj, që këto rekomandime do të ndihmojnë në parandalimin dhe eliminimin e rrethanave, që rezultuan me të gjeturat faktike.

Nga perspektiva personale, puna e Komisionit hetimor ishte përvojë pozitive në procesin e ndërtimit të institucioneve funksionale, efikase dhe efektive shtetërore. Partia e Drejtësisë si udhëheqëse e Komisionit hetimor dhe përfaqësuese e Grupit parlamentar "Për integrim", dëshmoi se potencialet demokratike për mbarëvajtjen e aktiviteteve të Kuvendit nuk qëndrojnë vetëm brenda grupeve të mëdha parlamentare por edhe brenda subjekteve të tjera, politike parlamentare. Besimin, që ma dha Kuvendi i Kosovës për të udhëhequr këtë Komision hetimor e kuptova si shprehje të mirënjohjes për angazhimin tim parimor politik në dy vitet e kaluara dhe si gatishmëri të Kuvendit për të afirmuar praktika të reja, më demokratike, të punës parlamentare.

“Kuvendi duhet ta ketë rolin e vet në ndërtimin e mekanizmave të sigurisë”

Intervistë me Z. Naim Malokun, kryetar i Komisionit të Kuvendit për siguri

Z. Maloku, si kryetar i një komisioni të Kuvendit, cilat janë aktivitetet kryesore që kanë ndodhur para themelimit të Komisionit për siguri?

Naim Maloku: Ishte projekti për trajnimin e Komisionit, sponsorizuar nga OSBE-ja, i cili ndihmoi shumë zhvillimin e këtij Komisioni. Komisioni për Gatishmëri dhe Emergjencë kishte autoritet të kufizuar, fushëveprim të kufizuar vetëm për Departamentin për Gatishmëri dhe Emergjencë. Ne praktikisht i hymë projektit të trajnimit të Komisionit, projekt ky gjashtëmujor, i cili përfshinte vizitat e Komisionit Parlamentar nëpër Kosovë - në Qendrën për Trajnim dhe Edukim në Vushtrri, pastaj në Inspektoratin e Policisë, vizitë në Slloveni e Maqedoni, për të parë përvojat dhe për të themeluar komunikimin me komisionet homologe atje. Kishte edhe vizita nga një ekspert parlamentar nga Franca, që merrej me çështje të sigurisë. Ai erdhi këtu me mbështetje të Agjencionit evropian për rindërtim – konsorciumit të katër parlamenteve evropiane.

Çfarë do të jetë përshkrimi i ri i punëve të Komisionit?

Naim Maloku: Fushëveprimi i Komisionit është votuar në Kuvendin e Kosovës. Fushëveprimi i Komisionit për Siguri që përfshin edhe ushtrimin e Mbikëqyrjes Parlamentare mbi Segmentet e Sig-



urisë në Kosovë - Shërbimin Policor të Kosovës, Agjencionit Antikorrupsion, TMK-së dhe segmenteve të tjera që do të ngritën në të ardhmen. Komisioni është bërë kompetent për shqyrtimin e ligjeve që vijnë në Kuvend të Kosovës nga Ministria e Punëve të Brendshme. Nga po kjo ministri tani i kemi dy ligje në procedure, Ligjin për Numrin Personal dhe Ligjin për Emrin Personal. Ne jemi në pritje edhe të Ligjit për Policinë. Një anëtar i Komisionit tonë ka marrë pjesë në grupin punues

për hartimin e ligjit, dhe gjithashtu presim ligjin për armët e vogla dhe ligjin për Shërbimin e Inteligjencës së Kosovës. Pra Komisioni tani është kompetent për shqyrtimin e këtyre projektligjeve, gjë që nuk ka qenë rasti më herët.

Cili është legjislacioni thelbësor për mandatin e tanishëm?

Naim Maloku: Ligji për Policinë është ligj të cilin e presim në Kuvendin e Kosovës. Jemi në një fazë të dëgjimeve

publike para Komisionit të segmenteve të sigurisë. Deri tani i kemi përfunduar tri dëgjime: Dëgjimin e Drejtorisë për Standarde të Policisë së Kosovës, kemi bërë Dëgjimin e Departamentit për Gatishmëri dhe Emergjencë dhe Dëgjimin e TMK-së.

Të gjitha këto aktivitete, gjithashtu edhe përkrahja e OSBE-së, e gjithë kjo është që Komisioni të përgatitet para detyrave që i ka, pra shqyrtimin e dy ligjeve, projektligjin për Policinë e Kosovës dhe projektligjin për Shërbimin Informativ të Kosovës. Këto janë dy projektligje që e presin pakon e Ahtisarit e ndoshta edhe Kushtetutën e Re të Kosovës.

Cilat janë çështjet më të rëndësishme lidhur me mbikëqyrjen e Qeverisë në fushën e sigurisë?

Naim Maloku: Është mbikëqyrja e SHPK-së. Ne kemi krijuar komunikim të mirë me SHPK-në, dhe mendoj se në këtë fazë në të cilën është Kosova duhet t'i kushtojmë shumë rëndësi efikasitetit të Shërbimit Policor të Kosovës.

Çfarë mendoni se do të jetë roli i Parlamentit në zhvillimin e sektorit të sigurisë në të ardhmen?

Naim Maloku: Kuvendi do ta ketë rolin e kontrollit dhe mbikëqyrjes përmes këtij Komisioni ose edhe komisioneve

të tjera që do të formohen, por në fazën që po vjen për Kosovën, Kuvendi duhet ta ketë edhe rolin e ngritjes së mekanizmave të sigurisë. Ne ende nuk e kemi p.sh. Shërbimin e Inteligjencës apo Shërbimin Informativ të Kosovës. Është një procedurë, një proces, ku Kuvendi përmes Komisionit duhet të kyçet në miratimin e ligjit, pastaj në zgjedhjen, në emërimin e njeriut të parë të Agjencionit. Ne jemi në proces, pra ka kaluar formimi i Agjencionit Anti-korrupsion në Kuvendin e Kosovës dhe ka kaluar në Kuvend edhe emërimi i drejtorit të Agjencionit Anti-korrupsion. Ne kemi një ide për ta bërë dëgjimin e atij Agjencioni para Komisionit për të parë deri ku ka arritur ngritja e kësaj strukture dhe pengesat e mundshme që i ka nga institucionet e Kosovës.

Cilat janë mundësitë sipas jush për bashkëpunimin parlamentar rajonal në fushën e sigurisë?

Naim Maloku: Ne e kemi krijuar një linjë komunikimi të mirë me Maqedoninë, pra me Komisionin Parlamentar për Siguri dhe Mbrojtje të Maqedonisë. Kemi linjë komunikimi të mirë me Komisionin Parlamentar për kontrollin e Shërbimeve Sekrete të Sllovenisë, kemi qenë në vizitë atje. Ne presim ta bëjmë një vizitë në fund të muajit shkurt në Kroaci, dhe gjatë muajit mars në Bosnje dhe Hercegovinë. Me këto vizita në krijojmë lidhje komunikimi me komisionet homologe, dhe normalisht me këto lidhje komunikimi ne ndikojmë direkt edhe në forcimin e bashkëpunimit të segmenteve

të sigurisë me rajonin. Kjo gjë është shumë me rëndësi për ta luftuar krimin e organizuar, pra është shumë me rëndësi që segmentet e sigurisë të rajonit të bashkëpunojnë. Në vizitat që i ka bërë Komisioni Parlamentar, pra vizitat në Maqedoni e Slloveni, pastaj në vizitat që do t'i bëjmë në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë, pra me neve vjen edhe zëvendës ministri i Ministrit të Punëve të Brendshme. Pra ne në kuadër të ekipit të Komisionit, në kuadër të delegacionit tonë e marrim edhe zëvendësministrin në mënyrë që drejtpërdrejtë të vendoset komunikimi edhe në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës dhe shteteve ku shkohet në vizitë. Nuk kemi krijuar ende një linjë komunikimi me Malin e Zi, por presim që edhe me ta të kemi një linjë komunikimi së shpejti. Sa i përket konferencave që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen parlamentare të segmenteve të sigurisë, kam marrë pjesë në shumë konferenca ndërkombëtare ku kanë qenë të pranishëm mysafirë nga Mali i Zi, Shqipëria, Bosnja e Hercegovina dhe këto janë disa linja komunikimi shpresëdhënëse për të ardhmen.

Si e vlerësoni bashkëpunimin parlamentar rajonal në çështjet konkrete siç janë industria e sigurisë private dhe fusha e bashkëpunimi për gatishmërinë dhe emergjenca?

Naim Maloku: Ne në kuadër të Komisionit kemi formuar grupin prej pesë anëtarëve të cilët janë të angazhuar për hartimin e ligjit për Kompanitë Private të Sigurisë. Një vizitë e këtij grupi do të bëhet

në Bullgari së shpejti, pastaj do të vizitohet edhe Gjermania dhe Britania e Madhe. Nga përvojat që merren atje do të hartohet ligji për Kompanitë Private të Sigurisë. Mendojmë që në muajin prill së bashku me organizatën joqeveritare "KIPRED" ta organizojmë një konferencë ndërkombëtare kryesisht rajonale lidhur me "Mbikëqyrjen Parlamentare të Segmenteve të Sigurisë", ku do t'i ftojme të gjitha parlamentet e rajonit këtu në Kosovë. Kjo është krejt në frymën e rritjes së bashkëpunimit rajonal në segmentin e sigurisë.

Si e vlerësoni ndikimin e Konferencës parlamentare rajonale për mbikëqyrjen e sigurisë që do të mbahet këtë vit?

Naim Maloku: Ne do të marrim përvoja nga këto shtete të rajonit, dhe për neve janë shumë të rëndësishme. Ne jemi në hapat ku nuk i kemi të ngritura të gjithë mekanizmat e sigurisë dhe normalisht krijimi i linjave të komunikimit me vendet e rajonit do të jetë një ndihmesë. Ne jemi të interesuar të krijohen edhe linjat e bashkëpunimit midis vetë ministrive të punëve të brendshme dhe segmenteve të tjera të sigurisë. Për neve është shumë me rëndësi përvoja që i kanë këto shtete në ushtrimin e mbikëqyrjes parlamentare të sigurisë, për shkak se jemi në hapat fillestar të marrjes së kësaj përgjegjësie si Komision dhe si Kuvend. Ne jemi të vetëdijshëm se nuk mundemi menjëherë të krahasohemi me shtetet e avancuara siç janë Franca, Gjermania, Britania e Madhe, por ne do të shohim se deri ku ka arritur rajoni dhe do të marrim disa nga përvojat e tyre.

Si e perceptoni Ju përkrahjen e OSBE-së për Komisionin?

Naim Maloku: Ne pa OSBE-në nuk do të kishim mundur ta ngrisim Komisionin fare dhe nuk do të kishim qenë në këtë fazë ku jemi. Ndihamë e OSBE-së ka qenë e pazëvendësueshme dhe unë shpresoj që do ta kemi ndihmën e OSBE-së edhe në këtë fazë kur do t'i shqyrtojmë projektligjet që janë të rëndësishme për Kosovën dhe në ngritjen e kapaciteteve të sigurisë të cilat nuk i kemi në Kosovë.

Cilat janë fushat ku mund të ketë përmirësime përbrenda Komisionit të cilat mund të përkrahen nga partnerët/organizatat nga jashtë?

Naim Maloku: DCAF-i është duke e trajnuar stafin e Komisionit tonë. Është një projekt dyvjeçar trajnimi që e bën DCAF-i, kështu që Komisioni do ta ketë edhe stafin e vet të përhershëm që do ta përcjellë punën e tij. Neve na intereson tani të kemi përkrahjen e OSBE-së për qasjen që duhet ta kemi ndaj shërbimeve sekrete ekzistuese në Kosovë. Janë disa Shërbime Inteligjence në Kosovë që ekzistojnë dhe funksionojnë. Ka edhe të partive të ndryshme politike që nuk janë legale dhe nuk janë në kontrollin e institucioneve të Kosovës. Ato shërbime ekzistojnë dhe kanë strukturat e veta, dhe tani kur ne duhet ta ndërtojmë një shërbim inteligjent duhet ta identifikojmë qasjen ndaj tyre, çfarë qasje ta kemi ndaj këtyre shërbimeve. Në këtë drejtim na duhet ndihma e OSBE-së për të parë përvojat e shteteve që kanë pasur një të kaluar si Kosova, ose të përafërt me ne.

Evropa e Bashkuar duhet të udhëheqë në zgjidhjen e çështjes së Kosovës

Joost Lagendijk, Anëtar i Parlamentit Europian dhe raportues për raportin e përgatitur së fundi të PE-së për Kosovën



Shtetet anëtare të BE-së duhet të jenë të bashkuara në përkrahjen e tyre për një sovranitet të kufizuar të Kosovës. Pavarësia është mënyra e vetme për të ecur përpara. Kjo do t'i siguronte Kosovës qasjen tejet të nevojshme në organizatat financiare ndërkombëtare dhe do t'ia mundësonte realizimin e perspektivës Evropiane. Sovraniteti i Kosovës duhet të kufizohet përmes një monitorimi ndërkombëtar për të ruajtur karakterin multi-etnik të Kosovës dhe për të mbrojtur interesat dhe sigurinë e popullatës serbe dhe të pakicave të tjera etnike. Këto janë bindjet themelore në draft raportin mbi të ardhmen e Kosovës dhe rolin e Bashkimit Europian të cilin ia kam paraqitur Parlamentit Europian.

Shtetet anëtare duhet që fuqimisht të qëndrojnë prapa Ahtisaarit, jo vetëm prapa propozimit të tij në dokument, por gjithashtu prapa deklaratave të tij që do të pasojnë mbi zgjidhjen e ardhshme. Kjo do të siguronte që transicioni deri te pavarësia të ndodhë

në mënyrë të rregullt. Në këtë pikëpamje, mënyra se si shtetet anëtare e njohin Kosovën e ardhshme të pavarur është shumë e rëndësishme: kjo do të duhej të bëhej në mënyrë shumëpalëshe, bashkërisht dhe në bazë të rezolutës së re të Këshillit të Sigurimit të KB-së.

BE-ja ka përgjegjësi speciale në Ballkan dhe veçanërisht në Kosovë. BE-ja rregullisht ka deklaruar përkushtimin e saj për integrimin e ardhshëm të rajonit në BE. Prandaj, Europa duhet të jetë kontrubuesi më i madh për praninë e ardhshme ndërkombëtare në Kosovë. Pavarësia do të ishte një hap i rëndësishëm, pasi që kjo do t'ia mundësonte BE-së pozicionimin e instrumenteve dhe të mekanizmave të saj për intervenim.

Situata aktuale në Kosovë nuk është e mirë. Që nga viti 1999, rajoni është qeverisur nga nëpunësit civil të KB-ve. Ndërkaq, politikanët vendor grinden dhe bëjnë luftë të brendshme, nga shkak që nuk kanë përgjegjësi mbi vendin e tyre. Zhvillim ekonomik pothuajse nuk ekziston. Shkalla e papunësisë është e lartë. Kompanitë nuk investojnë në Kosovë sa kohë që do të ketë paqartësi lidhur me statusin e Kosovës. BE-ja, e ka të vështirë që të realizojë projekte zhvillimore ngaqë nuk ka qeveri zyrtare me të cilën do të mund të kontraktonte.

Në një Kosovë të pavarur, kosovarët duhet të tregojnë përgjegjësi. Deri më tani, politikanët shqiptarë kanë pasur

vetëm një synim politik kryesor: pavarësinë. Kjo i verbon kundruall problemeve reale. Politikanët serb nuk marrin pjesë në Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes të themeluara nga Kombet e Bashkuara. Ata do të donin, por Qeveria e Serbisë u ka thënë të mos e bëjnë këtë, pasi që bashkëpunimi i tyre do të nënkuptonte njohjen e Kosovës si shtet sovran.

Por, mendimi im është se pakica serbe në Kosovë do të përfitojë nga zgjidhja përfundimtare. Kjo për faktin që zgjidhja përfundimtare e statusit duhet të ofrojë garanca të fuqishme për të drejtat e pakicave, veçanërisht përmes masave të zbatueshme të decentralizimit si dhe mbrojtjen e monumenteve kulturore dhe fetare. Për të garantuar këtë, bashkësia ndërkombëtare mbanën të drejtën e intervenimit në një numër të lëmive të rëndësishme.

Ky kufizim i sovranitetit të Kosovës do të duhej të zgjaste derisa Këshilli i Sigurimit i KB-ve të vendoste të transferonte tërë sovranitetin tek kosovarët. Por, kosovarët, si ata shqiptarë ashtu edhe ata serbë, duhet që sa më shumë që është e mundur të rregullojnë punët vet. Personeli ndërkombëtar nuk do të zëvendësojë më administratën vendore, por vetëm do t'a ndihmojë atë. Siguria mbetet të garantohet nga NATO, por gjithashtu edhe Kosova duhet të krijojë një forcë të vogël të armatosur, nën kontrollin e rreptë të KFOR-it, me fushë-

veprim dhe kapacitet të kufizuar dhe përfaqësim të të gjitha grupeve etnike.

Për Sërbinë, humbja e Kosovës vështirë përballohet. Milosheviqi, gjithashtu edhe pasardhësit e tij demokratik, kanë bërë çdogjë të mundshme për të shtuar rëndësinë e Kosovës për Serbinë. Gjithashtu, në fushatën e zgjedhjeve të kohëve të fundit, faktori Kosovë është përdorur nga një numër i kandidatëve. Por, sondazhet e opinionit tregojnë se votuesit kanë prioritetet të tjera, siç janë: standardi i tyre i jetes, siguria në rrugë dhe mundësia për të udhëtuar në Europë. Kosova dhe Serbia përfundimisht kanë të njëjtin qëllim: anëtarësimin në BE. Prandaj, ata duhet të bashkëpunojnë dhe kjo bëhet e mundshme sapo të qartësohet çështja e statusit.

Siç është pavarësia opcioni i vetëm i realizueshëm për Kosovën, anëtarësimi në BE është opcioni i vetëm për të ardhmen e Serbisë. Ne duhet të bëjmë çdogjë për të promovuar këtë. Presidenti Tadic ka theksuar që ekstradimi i Mladiqit në Gjykatën Ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë dhe anëtarësimi në BE janë dy prioritetet për vitin e ardhshëm. Partia e tij ka siguruar një rezultat të shkëlqyeshëm në zgjedhje. Ne duhet të përkrahim Serbinë në çfarëdo mënyre që mundemi. Prioriteti i Brukselit duhet të jetë integrimi gradual i vendeve të Ballkanit perëndimor në BE. Vetëm në këtë mënyrë mund të parandalojmë 'ballkanizimin' e Ballkanit.

Nga Kapitol Hill në Kosovë

Polly Trottenberg, Drejtoreshë legjislative e Senatores së SHBA-ve Barbara Boxer nga Kalifornia (SHBA). Znj. Trottenberg vizitoi Kosovën në dhjetor të vitit 2006 me ftesë të Institutit Demokratik Kombëtar (NDI).



Njohja ime me politikën kosovare ngjau në një kohë mjaft të zënë me punë, në fund të dhjetorit. Ishte koha, kur Kuvendi i Kosovës sikurse edhe Kongresi Amerikan, po përpiqej të përmbyllë punët për buxhetin dhe të shkojë në pushime. Partitë po ziheshin, dhe një prej partive minoritare ishte larguar, duke ia mohuar kështu partisë shumicë kuorumin. Deri në fund të asaj jave, pas shumë nxitjeve nga bashkësia ndërkombëtare, partitë u mblodhën dhe miratuan buxhetin gati unanimisht, gjë që është më shumë se që do të mund të thoshte Kongresi Amerikan për vete.

Në këndvështrimin amerikan, si zakonisht, kjo është politika. Kultura politike dhe kushtetuese është e dizajnuar për konfrontime të vazhdueshme, por kur partitë dështojnë të bashkëpunojnë mbi çështjet me rëndësi, ata dënohen në këtë rast nga vet votuesitë.

Sistemi aktual zgjedhor me "lista të mbyllura" nuk është akoma ajo çfarë ne në Shtetet e Bashkuara do t'a quanim demokraci reprezentative me votuesë që votojnë për kandidatë që kandidohen për pozita. Akoma nuk është bërë e qartë sesi votuesit do të shprehin vullnetin e tyre

në kutitë e votimit. Sistemi zgjedhor i Kosovës është gjithashtu shumë i centralizuar – nuk ka njësi votimi akoma, dhe UNMIK-u ka parashtruar kushtin që 30% të listave të jenë gra dhe ka përcaktuar 20 vende të jenë të rezervuara për minoritetet etnike.

Me "Kryesinë" tetë anëtarëshe, dhe tok me Kryeministrin dhe Kryetarin, struktura e Kuvendit është shumë e ndërlikuar për një vend të vogël si Kosova. Përveç kësaj, Kuvendit i mungon transparencja: Kryesia cakton shumicën e rendit të ditës prapa dyerve të mbyllura, votat e anëtarëve të Kuvendit nuk numërohen, dhe kopjet e projekt-ligjeve dhe amendamenteve nuk mund të merren lehtë.

Për anët pozitive mund të thuhet që: debatet në Kuvend janë publike, poashtu edhe dëgjimet në Komisione, dhe se ekziston një korpus i fuqishëm medial që mbulon aktivitetet e Kuvendit në mënyrë shumë të drejtë. Kuvendi tanimë ka krijuar rregulloren e punës dhe ka filluar të zhvillojë stafin e Kuvendit në mënyrë profesionale, edhe përkundër faktit që atyre tani ju mungojnë mjetet themelore të punës legjislative siç janë zyra për draftim, zyra për hulumtim madje edhe rrjeti i kompjuterëve.

Gjithashtu nuk ekziston një traditë e gjatë e trajnimeve dhe praktikave në politikat publike, por tani janë duke u bërë përpjekje edhe në këtë drejtim.

Komisionet Parlamentare

kanë filluar të angazhohen në mbikëqyrjen e ekzekutivit, por nuk ekziston ndonjë mekanizëm për të shtyrë degën e ekzekutivit të implementojë ato çfarë ka miratuar Kuvendi, dhe nuk ka rrugë të qartë të harmonizimit të dispozitave ligjore me resurset financiare. Në diskutimet tona mbi mbikëqyrjen, stafi i Kuvendit të Kosovës ishte posaçërisht i interesuar në mekanizmat që stafi i kongresit të Shteteve të Bashkuara ka vënë në dispozicion siç janë: autoriteti i thirrjes, Aktin për Lirinë e Informimit dhe ligjet për mbrojtjen e atyre që gjejnë të meta tek qeveria. Ne gjithashtu kemi diskutuar sesi në pushtetin një partiak në SHBA në gjashtë vitet e fundit, mbikëqyrja nga ana e kongresit është atrofuar me pasoja serioze buxhetore dhe të politikave.

Ekziston një urgjencë e veçantë që Kuvendi i Kosovës të përmirësojë transparencën dhe mundësitë e veta për politikë-bërje sepse kur statusi i vendit të jetë zgjidhur, sigurisht, brenda një apo dy muajve, ata do të kenë për detyrë që në mënyrë të shpejtuar të miratojnë pakon legjislative gjithëpërfshirëse - kushtetutën, definimin e kufinjëve komunal, ligjin për zgjedhje, mbrojtjen e minoriteteve dhe gjyqësorin e pavarur.

U habita kur dëgjova që Kombet e Bashkuara do të presin nga Kuvendi i ri i Kosovës të përmbushë obligimet e lartpërmendura brenda

disa muajve dhe se nuk do të ofronin pavarësinë pa u përmbushur ato. Në kontekstin politik amerikan është e parrealizueshme që të pritet që një vend i ri i cili akoma është duke formalizuar Kuvendin dhe partitë politike t'ju adresohet çështjeve aq të thella për aq pak kohë, por mund të jetë e realizueshme për Europën ku aq shumë vende post-komuniste ia kanë dalë mbanë dhe shumë shpejt kanë adoptuar modelin europian.

Ndiejë gjithashtu që tek bashkësia ndërkombëtare ekziston dëshira që Kosova të vendosë çdo gjë që ka të bëjë me qeverinë e ardhshme dhe sistemin zgjedhor dhe atë sa më shpejtë dhe në mënyrë përfundimtare, për çfarë brengosem se nuk do të mund të sigurojë tërë debatin publik të nevojshëm si dhe arritjen e konkonzusit. Për shembull, nga këndvështrimi amerikan, vendimi që të krijohen kuota të përhershme etnike dhe gjinore në kuadër të Kuvendit është vendim i rëndësishëm për të cilin duhet të ketë debat publik, dhe unë kam dëgjuar mjaft shqetësime nga ana e shumë kosovarëve lidhur me këto kuota.

Megjithatë besoj shumë që bashkësia ndërkombëtare, e cila ka bërë punë të mrekullueshme në Kosovë, do të ndihmojë që Kosova të bëhet reprezentative me demokraci transparente me "lista të hapura" dhe njësi votimi, dhe që kosovarët do duhet të rishqyrtojnë dhe formësojnë sistemin e tyre zgjedhor sipas nevojave që kanë.

Buxheti i Kosovës dhe sfidat e së ardhmes së afërt

Nazim Jashari, Anëtar i Kuvendit të Kosovës, Partia reformiste ORA

Para ca kohësh Kuvendi i Kosovës votoi Buxhetin e Konsoliduar të vendit për vitin 2007. Edhe kësaj radhe buxheti i miratuar i institucioneve të përkohshme të qeverisjes nuk kishte ndonjë dallim qenësor nga buxhetet e viteve të mëparshme. Thuaja e njëjta shumë me atë të vitit paraprak, e njëjta metodologji e realizimit të të hyrave, e njëjta pjesëmarrje e të ardhurave të realizuara në doganë si dhe afërsisht e njëjta shpërndarje nëpër agjenci shpenzuese.

Ky inercion i planifikimit të buxhetit në rrethanat kur të hyrat aktuale buxhetore mezi sigurojnë minimumin e funksionimit të institucioneve do të ishte krejtësisht i paparamendueshëm në një vend me qeverisje normale dhe me një politikë të përgjegjshme ndaj qytetarëve të vet. Në vende të tilla qeveria që do të mund ta siguronte përkrahjen e nevojshme shoqërore do të detyrohej t'i futej reformave të thella në legjislacionin fiskal për të siguruar më shumë të hyra dhe për t'i amortizuar pakënaqësitë e shtresave të goditura shoqërore që do të mund ta rrezikonin stabilitetin e vendit.

Qeveria e Kosovës nuk bëri asnjë lëvizje për të përmirësuar në mënyrë më të ndjeshme masën e të hyrave, por u kënaq me këtë sistem inertiv, në rend të parë për shkak të mungesës së kapaciteteve profesionale të përgjegjësve sektorialë e që për rrjedhojë ka shkaktuar një vartësi të plotë dhe një nënshtrim të padiskutueshëm ndaj zyrtarëve ndërkombë-



tarë që mbikëqyrin punën e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, qofshin ata zyrtarë të Unmikut, të FMN-së apo të Bankës Botërore.

Madje ky inercion i Qeverisë u bart edhe në Kuvendin e Kosovës, ku projekti i buxhetit për vitin 2007 u soll që të votohej duke mos pasur as numrin minimal të nevojshëm të deputetëve që do të mund ta siguronin kuorumin e domosdoshëm për ta kaluar ligjin. Kjo bëri që herën e parë votimi i projek-tbuxhetit të dështonte sepse përfaqësues të partive opozitare që kishin vërejtje të shumta dhe parimore qoftë lidhur me ndarjet, qoftë me mënyrën joserioze të procedimit gjatë miratimit të tij në Komisionin e Buxhetit të Kuvendit, nuk morën pjesë në krijimin e kuoromit të domosdoshëm për të mundësuar votimin, siç e parasheh korniza kushtetuese e Kosovës.

Duhet të thuhet këtu se UNMIK-u që ka fjalën kryesore në administrimin e Kosovës, për shumë arsye, nuk ka

ndonjë ndjeshmëri të theksuar lidhur me vlimet shoqërore në vend. Arsyeja kryesore është se zyrtarët e UNMIK-ut janë të kënaqur me nivelin e ndihmesës që ua sigurojnë institucionet vendore në administrimin e Kosovës, përderisa paqja sociale po mbahet në mënyrë të kënaqshme për ta. Edhe pse gjatë vitit të kaluar patëm disa herë greva nga sindikatat e mësuesve dhe të punonjësve shëndetësorë këto greva përfunduan ashtu siç nisën duke mos ia arritur synimeve të paralajmëruara nga organizatorët për ta ndryshuar cilësisht gjendjen e këtyre dy grupimeve profesionale.

Ndikim të madh, rreth kësaj, ka luajtur edhe statusi i pazgjithur i Kosovës që po vepron si amortizator i pakënaqësive sociale. Kjo nuk do të mund të vazhdojë për një kohë të gjatë nëqoftë se urgjentisht nuk bëhet një rishpërndarje më e drejtë e të ardhurave në sektorin publik përfshirë këtu edhe PTK-në, Aeroportin e sidomos KEK-un, i cili përkundër humbjeve të vazhdueshme që krijon qëndron shumë lart me të ardhura në krahasim me të punësuarit e tjerë të sektorit publik.

Ekziston një rrezik i theksuar që të gjitha këto pakënaqësi të grumbulluara të shpërthejnë shumëshpejt dhe atë në mënyrë të pakontrolluar pas definimit të statusit përfundimtar të Kosovës, që duket se do të përmbillet në gjysmën e parë të këtij viti, nëqoftëse nuk do të ketë ndonjë zhvillim pozitiv në rrafshin ekonomik që do të mund ta zgjonte shpresën për

një përmirësim të përshpejtuar të kesaj gjendjeje.

Në aspektin e shpenzimit të buxhetit të vitit të kaluar duhet të përmendet një përpjekje e vakët e qeverisë për të rritur nikoqirllëkun me rastin shpenzimeve buxhetore të vitit 2006, që solli kursimin e disa milionave, posaqërisht në pozicionin "Mallra dhe Shërbime", e që duket se u reflektua në rritjen e vogël të shumës në pozicionin "Shpenzime Kapitale", për vitin 2007, mirëpo larg nga niveli i kursimit i cili duhet të dëshmohej nga institucionet tona kur të kihet prasysh gjendja e rëndë socio-ekonomike në Kosovë.

Sidoqoftë, procesi i buxhetimit duhet të përmirësohet ndjeshëm në stadin në të cilën po përgatitemi të hyjmë si shoqëri, pas përcaktimit të statusit final. Përgatitjet duhet të fillojnë shumë më heret, por dhe disciplina në zbatimin e dispozitave ligjore lidhur me procesin e hartimit të buxhetit duhet të jetë shumë më e lartë, duke ndëshkuar zyrtarët të cilët bien ndesh me këto norma, gjithmonë në përputhje me nenet e Ligjit mbi Menagjimin e Financave Publike, e që nuk ka ndodhur asnjëherë deri më sot, përkundër shkeljeve të shumta. Por, mbi të gjitha, do të duhej të bëheshin ndërrime personale, duke sjellur në krye të këtyre sektorëve njerëz më të përgatitur se sa këta që aktualisht po i ushtrojnë këto përgjegjësi e që të gjitha shpresat i kanë varur te ndonjë mrekulli e Zotit për t'i përmirësuar rrjedhat financiare në vend.

Zhvillimet e fundit në Kuvendin e Kosovës gjatë muajve: dhjetori 2006 dhe janar 2007

Komisioni i Kuvendit për Siguri organizoi dëgjim mbi gatishmërinë emergjente

S i pjesë të dëgjimeve të vazhdueshme nga Komisioni i Kuvendit për Siguri mbi gatishmërinë e qeverisë gjatë situatave emergjente janë organizuar dëgjimet më 6 dhjetor 2006 me Departamentin e Ministrisë për Menaxhim Emergjent, dhe më 23 janar 2007 me Trupat Mbrojtëse të Kosovës. Gjatë diskutimeve u bë e qartë, që duhet të ndërmerren veprime të mëtutjeshme nga të dyja palët, nga Kuvendi dhe Qeveria, veçanërisht në dritën e Ligjit mbi katastrofat natyrore të miratuar rishtas. Ky Komision, në vazhden e aktiviteteve tjera ka planifikuar të organizojë edhe një dëgjim me Zyrën për Siguri Publike në muajin mars, dhe ka kërkuar nga Departamenti për Menaxhim të Emergjencave të Ministrisë t'i raportojë Komisionit brenda gjashtë muajve mbi zbatimin e ligjit mbi katastrofat natyrore.

Kryetari i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së vizitoi Kosovën



Një delegacion i Asamblesë Parlamentare OSBE-së, i kryesuar nga kryetari Goran Lennmarker, vizitoi Kosovën më 12-13 dhjetor 2006. Ky delegacion, i përbërë nga ambasadori Andreas Nothelle dhe z. Roberto Battelli, mbajti takim me Kryetarin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës si dhe me shefat e grupeve parlamentare. Rëndësia e mbikëqyrjes parlamentare të qeverisë dhe roli qenësor i institucioneve të pavarura në shoqërinë demokratike ishin temat specifike të këtij diskutimi. Gjithashtu, është diskutuar për zhvillimet e përgjithshme politike lidhur me procesin e statusit dhe ngarkesën e punës shtesë që pritet në Kuvend, dhe që ka të bëjë me shqyrtimin e pjesëve të legjislacionit kyç, i cili nevojitet për zbatimin e zgjedhjes së statusit. Gjatë vizitës së tyre dyditore, ky delegacion u takua me Presidentin e Kosovës dhe përfaqësuesit e institucioneve të pavarura, përfshirë këtu edhe Ombudspersonin dhe Agjencinë për Anti-Korrupsion.

tuar për zhvillimet e përgjithshme politike lidhur me procesin e statusit dhe ngarkesën e punës shtesë që pritet në Kuvend, dhe që ka të bëjë me shqyrtimin e pjesëve të legjislacionit kyç, i cili nevojitet për zbatimin e zgjedhjes së statusit. Gjatë vizitës së tyre dyditore, ky delegacion u takua me Presidentin e Kosovës dhe përfaqësuesit e institucioneve të pavarura, përfshirë këtu edhe Ombudspersonin dhe Agjencinë për Anti-Korrupsion.

Kuvendi miratoi Buxhetin e Kosovës për vitin 2007

Në seancën e fundit të vitit 2006, Kuvendi i Kosovës u desh të merrej me një numër çështjesh sfiduese. Largimi i Par-

tisë Demokratike (PDK-së) dhe pasimi i mungesës së kuorumit rrezikoi miratimin e Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2007 (BKK). Kryetari i Kuvendit caktoi një seancë të veçantë më 23 dhjetor, duke kërkuar që të jenë prezentë të gjithë deputetët e Kuvendit të koalicionit dhe BKK-ja u aprovua me 65 vota për. Rezultati la të kuptohet që anëtarët e LDK-së, përkundër kundërshtimeve të brendshme, mbetën të bashkuar në mbështetjen e koalicionit qeveritar. PDK-ja ka kritikuar ashpër qeverinë, përfshirë këtu akuzat për korrupsion, mungesën e ekspertëve, alokimin jo të duhur të fondeve si dhe mungesën e kujdesit ndaj problemeve sociale dhe varfërisë.



Kuvendi debatoi mbi gjendjen e energjisë

Më 21 dhjetor 2006 Kuvendi organizoi një debat të zgjeruar mbi politikën mbi gjendjen në energji. Ministri i Energjisë dhe Minierave z. Et'hem Ceku bëri një prezantim në fillim të debatit. Deputetët e Kuvendit nga opozita kritikuan ashpër qeverinë dhe UNMIK-un për politika të dobëta mbi energjinë dhe planifikimin. Debatu dominohej nga deputetët e opozitës por fjalën gjithashtu morën edhe deputetët e Kuvendit nga koalicioni.

Kuvendi miratoi emërimin e dy kandidatëve për Bordin e Mediave për Ankesa

Gjatë seancës plenare më 11 janar, 2007, Kuvendi miratoi me akt pro forma dy kandidatë vendor për Bordin për Ankesa i Mediave. Bordi për Ankesa i Mediave (BAM) është organi i tretë i KPM-së, i cili përbëhet nga Zyra e KPMK-së, Këshilli i KPMK-së dhe BAM-së. Kandidatët janë emëruar më parë nga Gjykata Supreme e Kosovës, me 65 vota për dhe

gjashtë kundër, si dhe pesë abstenime. Që të dy kandidatët z. Avdi Dinaj (gjykatës në Gjykatën Supreme) dhe z. Anton Nokaj (Kryetar i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë), janë miratuar të jenë anëtarë vendorë të Bordit për Ankesa të Mediave. Bazuar në Ligjin mbi Komisionin e Pavarur të Mediave (KPMK), Bordi për Ankesa të Mediave përbëhet prej tre anëtarëve, një ndërkombëtar dhe dy vendor. Përderisa anëtari ndërkombëtar është emëruar nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm, dy anëtarët vendor janë emëruar nga Gjykata Supreme dhe më pas janë zgjedhur pro forma nga Kuvendi. Me zgjedhjen e dy anëtarëve të rinj të BAM-së, është finalizuar themelimi zyrtar i të tre organeve të KPMK-së.

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve organizoi vizita në terren



Gjatë dhjetorit 2006 – janarit 2007, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve (KDIKK) i kryesuar nga z. Rangjel Nojkiq (SLKM), vizitoi disa komuna për të mbledhur informacione për të kthyerit, të drejtat e komunitetit dhe proceset e integritimit në komunë. Vizitat u zhvilluan në Klinë, Novobërdë dhe Ferizaj. Kjo vizitë ishte pjesë e projektit të implementuar nga OSBE-ja, për të shtuar efikasitetin e funksionimit të Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve.

Anëtari i ri i Kryesisë së Kuvendit përfaqëson "Komunitetet tjera"

Më 11 janar, 2007 seanca plenare e Kuvendit miratoi emërimin e z. Bislim Hoti (komuniteti egjiptian) që të jetë anëtar i ri i Kryesisë së Kuvendit. Zëvendësimi i kësaj ulëseje në Kryesinë e Kuvendit, siç është arritur marrëveshja ndërmjet përfaqësuesve të "komuniteteve tjera" në dhjetor të vitit 2004, merr parasysh parimin e rotacionit ndërmjet komuniteteve. Nga që z. Hoti i përket Iniciativës së Re Demokratike të Kosovës (IRDK) dhe është anëtar i grupit parlamentar



të AAK-së, disa deputetë të Kuvendit e kundërshtuan këtë zëvendësim, duke pohuar që kjo do të ndikonte në balancimin e kompetencave brenda Kryesisë. Më pas Zyra Ligjore e UNMIK-ut, bazuar në Kornizën Kushtetuese qartësoi që ulësja në Kryesi është rezervuar për komunitetet tjera, pavarësisht nga përkatësia politike e tyre, dhe kësaj z. Hoti është konfirmuar të jetë anëtar i ri i Kryesisë



Komisioni i Kuvendit organizoi dëgjim publik për Ligjin mbi TVSH-në

Më 17 janar 2007 Komisioni i Kuvendit për Buxhet dhe Financa organizoi dëgjim publik mbi Tatimin në Vlerën e Shtuar (TVSH). Në këtë dëgjim morën pjesë përfaqësuesit e mediave të shkruara, Këshilli për Shtyp i Kosovës, Asociacioni i Gazetarëve Profesionalistë të Kosovës, Mediat e Pavarura Elektronike në Kosovë, bizneset dhe OJQ-të. Komisioni u informua për Urdhëresën e BE-së mbi TVSH-në, e cila veçanërisht lejon shkallë të reduktuar të TVSH-së, e cila veçanërisht ka të bëjë me vlerën e reduktuar për furnizimin me libra, gazeta dhe botime periodike. OSBE-ja paraqiti arsyet e pse mediat e shkruara duhet të lirohen nga TVSH-ja, duke cituar shembujt nga rajoni dhe Europa. Lirimi i mediave të shkruara nga TVSH-ja është njëri prej rekomandimeve kryesore, që përfaqësuesi i OSBE-së për Lirinë e Mediave i bëri në raportet e tij të përgatitura për vitin e kaluar.

Udhëzimet trasojnë rrugën për hartimin e legjislacionit

Alfons B. Lentze LL.M., Konsulent për projektin 'Përkrahja e vazhdueshme për Kuvendin e Kosovës'. Projekt ky i financuar nga BE-ja, menaxhuar nga AER-i dhe implementuar nga Konzorciumi i Paramenteve të Gjermanisë, Belgjikës, Francës, Sllovenisë dhe Instituti Ndërkombëtar de Paris la Défense



Alfons B. Lentze

Është me rëndësi esenciale për institucionet e Kosovës që të krijojnë një metodologji të drejtuar në procesin e hartimit apo ndryshimit të legjislacionit me synim që të gjithë akterët brenda institucioneve të Kosovës të shfrytëzojnë sistemin e njëjtë në hartimin e ligjeve. Për momentin institucionet e Kosovës janë duke shfrytëzuar modele të ndryshme gjatë hartimit të ligjeve. Ekspertët e ndryshëm ndërkombëtar japin kontributet e ndryshme të tyre në procesin e hartimit. Gjithashtu nëpunësit civil brenda institucioneve të Kosovës janë trajnuar bazuar në modelet e BE-së dhe SHBA-ve. Synimi nuk është që të zhvillohet një model i cili mundet të shfrytëzohet për të hartuar legjislacionin mirëpo të zhvillohet një logjikë e thjeshtë në kuadër të procesit hartues. Kjo logjikë e thjeshtë duhet të ofrojë hapësirë për kreativitet dhe shkathësi për secilin jurist që vepron në kuadër të kornizave të caktuara me mjete të rëndomtë.

Udhëzimet për hartimin e legjislacionit do të ndihmojnë juristët që të luajnë një rol më përgjegjës në procesin e har-

timit të ligjeve dhe zbatimit të praktikave më të mira. Juristët dhe politikëbërësit në fushat e ndryshme profesionale janë në gjendje të kuptojnë pozitën e juristëve legjislativ në procesin e ligjëvënies. Çdo jurist duhet të kuptojë se ligji mund të krijohet në bazë të pushtetit të besuar (sundimi i ligjit). Organet ekzekutive janë të obliguara sipas ligjit, veprimet ekzekutive mund të zbatohen vetëm nëpërmjet të legjislacionit. Juristët ligjëvënës duhet të dinë që ligji ka një vlerë të rrallë: ligji duhet të përmbushë pritjet e publikut në përgjithësi. Udhëzimet do të përmirësojnë cilësinë e ligjeve dhe kërkesat cilësore janë të rëndësishme për mbrojtjen e ligjshmërisë dhe implementimin. Ligji duhet të jetë i zbatueshëm; ligji duhet të jetë i thjeshtë, qartë dhe në të ketë qasje në të. Parimi i subsidiaritetit dhe proporcionalitetit duhet mbrojtur.

Është e qartë se një projektligji duhet shkruar në gjuhën juridike që ka të bëjë me sistemin e gjerë juridik pjesë e të cilit do të jetë ligji. Formulimet, termet dhe konceptet të cilat përdoren në projektligji duhet të koordinohen me përmbajtjen e ligjeve të tjera dhe sistemin e gjerë juridik të cilës këto ligje i përkasin. Është me rëndësi që këto kërkesa të koordinimit të përmbushen, sepse në të kundërtën ligji i ri mund lehtë të fusë paqartësi ligjore në kuadër të sistemit juridik. Në fakt një ligji i tillë mund të rezultojë në pabarazi dhe padrejtësi të tjera pas filimit të zbatimit të tij

Rëndësia e udhëzimeve – të ndryshme nga rregullat e rrepta – qëndron në faktin që ato ofrojnë hapësirë për kreativitet për juristët dhe hartuesit e ligjit. Fillimisht, juristi ligjëvënës duhet të jetë në gjendje të flasë në mënyrë të rrjedhshme gjuhën juridike dhe të ketë një kuptim gjithëpërfshirës të ligjit. Juristi ligjëvënës duhet të lexojë gjithë precedentin gjyqësor, revistat ligjore dhe të ndjekë të gjitha zhvillimet juridike dhe legjislativ.

Juristët ligjëvënës duhet të jenë të vetëdijshëm se në procesin legjislativ shumë gjuhë të tjera fliten, si p.sh.: gjuha e politikëbërësve, ekonomistëve, profesionistëve shkencor, gjuha e përditshme e njerëzve etj. Është me rëndësi thelbësore që juristi ligjëvënës të kuptojë këtë proces dhe që ai/ajo të kuptojë të mendojë dhe komunikojë në gjuhët tjera nga ajo juridike. Akterët e ndryshëm në procesin legjislativ të cilët nuk flasin gjuhën juridike, të gjithë zënë pozitë të tyre legjitime në procesin ligjëvënës.

Hartimi i kornizës ligjore e cila plotëson standardet e BE-së është preokupimi kryesor në vendet e Europës Qëndrore dhe Lindore dhe kjo jo vetëm për të nxitur zhvillimin ekonomik por gjithashtu edhe të sigurojë një të ardhme më të mirë të qytetarëve. Për të arritur këto qëllime, është me rëndësi të krijohet një strukturë e shëndoshë institucionale, të disponohet me një staf të kualifikuar në hartimin e ligjit, të themelohen procedura efikase për koordinim dhe

konsultim dhe të sigurohet që ndikimi i mundshëm i instrumenteve ligjore të vlerësohen përpara se ato të miratohen.

Një program i financuar i BE-së: programi SIGMA i OZHBE ofron përkrahje për vendet partnere në përpjekjet e tyre për të modernizuar sistemet e qeverisjes publike. Nga SIGMA është kërkuar nga disa vende përfituese të saj t'ju ndihmohet atyre në këtë detyrë tejet të vështirë për themelimin e strukturave efikase dhe të efektshme për hartimin e ligjit. SIGMA ka hartuar një listë për t'ju ofruar vendeve mjete shtesë për vetëvlerësim. Kjo listë ofron mjetet për vlerësimin e strukturave, procedurave dhe teknikave për përgatitjen dhe hartimin e legjislacionit dhe për identifikimin e metodologjive të cilat mund të jenë të dobishme kur të merren parasysh ndryshimet në fjalë. Hartimi i ligjeve përbëhet nga dy faza: hartimi i politikave dhe përgatitja e tekstit legjislativ për të futur në fuqi politikën e miratuar. Kjo listë ka të bëjë kryesisht me këtë fundit.

Lista bazohet në përvojat e grumbulluara nga OZHBE dhe vendet e Evropës lindore dhe Qëndrore. Në veçanti, ajo merr parasysh kontekstin e përafritimit të ligjit në aspektin e integritetit në BE. Lista është e dizajnuar që të ofrojë mekanizma praktikë për të gjithë ata që janë përgjegjës për themelimin apo revidimin e procesit hartues. Ajo së këndejmi ofron jo vetëm çështjet që kanë të bëjnë me vetë ligjin, por edhe ato që kanë të bëjnë çështjet organizative dhe të personelit.

Organizimi i procesit hartues – përfshirë këtu edhe stafin adekuat – është bazë kyçe për prodhimin e instrumenteve të mira juridike. Krahas kësaj është dëshmuar të jetë e rëndësishme që të ndërmerren një varg verifikimesh si gjatë procesit të zhvillimit të politikave gjithashtu edhe gjatë procesit hartues.

Lista mbulon çështjet si në vijim: kontrollimet e politikave, hartimin e legjislacionit primar, hartimin e legjislacionit sekondar, verifikimet specifike për hartimin e ligjit dhe publikimin e legjislacionit. Lista ka të bëjë me kornizën ligjore si tërësi, përfshirë këtu personelin hartues, instrumentet për verifikimin e drafteve, përkrahjen për teknologjinë kompjuterike dhe sistemet e menaxhimit të dokumenteve dhe procedurat e konsultimit. Ajo gjithashtu ndërlidhet me hartimin e legjislacionit primar dhe sekondar dhe sugjeron çështje që të merren parasysh në lidhje me procedurat, caktimin e detyrave, kohën dhe rolin e parlamentit në përgatitjen e të dyja llojeve të legjislacionit.

Lista pasqyron parimet e vendim-marrjes së mirë të cilat janë në përdorim nga vendet anëtare të OZHB-së për të përmirësuar efektshmërinë dhe efikasitetin e rregulloreve qeveritare duke përmirësuar bazën ligjore dhe faktike për rregullore, sqarimin e opsioneve, ofrimin e ndihmës në arritjen e vendimeve më të mira dhe themelimin e proceseve më të rregullta dhe parashikueshme të vendim-marrjes, identifikimin e rregulloreve ekzistuese të cilat janë të vjetruara apo panevojshme dhe bërjen e veprimeve të qeverisë më transparente. Mirëpo ato duhet të aplikohen

në kuadër të një sistemi më të gjerë të menaxhimit juridik që përfshinë elemente siç janë mbledhja dhe analiza e informatave, proceset e konsultimit dhe vlerësimi sistematik i rregulloreve ekzistuese.

Lista:

1. A është i përkufizuar problemi si duhet?

Problemi që duhet të zgjidhet duhet të theksohet në mënyrë të saktë duke dhënë dëshmi të qarta për natyrën dhe fushëveprimin e tij dhe duke shpjeguar se përse ky problem është ngritur.

2. A është veprimi qeveritar i justifikuar?

Intervenimi qeveritar duhet të bazohet në dëshmi të qarta se veprimi qeveritar është i justifikuar duke marrë parasysh natyrën e problemit, përfitimet dhe shpenzimet e mundshme të veprimit (bazuar në vlerësimin realist të efektshmërisë së qeverisë) dhe mekanizmat alternative për trajtimin e problemit.

3. A është ligjbërja forma më e mirë e veprimit qeveritar?

Ligjbërësit duhet të kryejnë, gjatë fazave të hershme të procesit të ligjbërjes, një krahasim të instrumenteve të politikave të ligjbërjes dhe ato që nuk ndërlidhen me ligjbërjen, duke konsideruar çështjet relevante siç janë shpenzimet, përfitimet, efektet e shpërndarjes dhe kërkesat administrative.

4. A ekziston baza ligjore për ligjbërje?

Proceset e ligjbërjes duhet të strukturohen ashtu që të gjitha vendimet e ligjbërjes të respektojnë "sundimin e ligjit"; që është se përgjegjësia duhet të jetë eksplicite

për të siguruar që të gjitha ligjet të autorizohen nga ligjet e nivelit më të lartë dhe të jenë në pajtim me detyrimet e traktatit dhe parimet ligjore relevante siç janë qartësia, proporcionaliteti dhe kërkesat procedurale të zbatueshme.

5. Cili është niveli i duhur (apo nivelet) e qeverisë për këtë veprim?

Ligjbërësit duhet të zgjedhin nivelin më të duhur të qeverisë që të merr veprime apo nëse nivelet e shumfishta janë të përfshira duhet të dizajnojnë sistemet efektive të koordinimit ndërmjet niveleve të qeverisë, për shembull në nivel komunal.

6. A arsyetojnë përfitimet e ligjbërjes shpenzimet?

Ligjvënësit duhet të vlerësojnë shpenzimet e përgjithshme të pritura dhe përfitimet e secilit propozim dhe të alternativave të realizueshme dhe duhet të vëjë vlerësimet në dispozicion në formatin e qasshëm për vendim-marrësit. Shpenzimet e veprimit qeveritar duhet të arsyetohen nga përfitimet para se të ndërmerren ndonjë veprim.

7. A është shpërndarja e efekteve në tërë shoqërinë transparente?

Deri në masën në të cilën vlerat shpërndarëse dhe të barazisë ndikohen nga intervenimi qeveritar, ligjvënësit duhet të bëjnë transparente shpërndarjen e shpenzimeve dhe përfitimeve përtej grupeve shoqërore.

8. A është ligji i qartë, konsistent, i kuptueshëm dhe i lehtë për qasje për të gjithë shfrytëzuesit?

Ligjvënësit duhet të vlerësojnë nëse rregullat do të jenë të kuptuara nga shfrytëzuesit e mundshëm dhe në këtë drejtim duhet të ndërmerren hapa për të siguruar që teksti dhe struktura e rregullave të jetë sa më e qartë që të jetë e mundshme.

9. A kanë pasur të gjitha palët e interesuara mundësinë që të shprehin pikëpamjet e tyre?

Ligjvënësit duhet të zhvillohen në një mënyrë transparente dhe të hapur me procedurat e duhura për dhënien e kontributit efektiv dhe me kohë nga ana e palëve të interesuara.

10. Si do të arrihet zbatimi i ligjeve?

Ligjvënësit duhet të vlerësojnë nxitësitë dhe institucionet nëpërmjet të të cilëve ligji do të hyjë në fuqi, dhe të dizajnojnë strategjitë përkatëse për implementim që do të bëjnë që ligjet të zbatoheshin në tërësi

Vërejtje: Ky artikull nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet dhe mendimet e Projektit të Financuar nga BE-ja 'Përkrahja e mëtejme për Kuvendin e Kosovës' dhe në asnjë mënyrë nuk pret aktivitetet dhe politikat e tij në këtë fushë. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e autorit. Informatat e përmbajtura në këtë artikull përfshirë këtu edhe çfarëdo shprehje të mendimit dhe çfarëdo projektimi apo parashikimi janë marrë dhe bazohen kryesisht në burimet publike të cilat autori mendon se janë të qëndrueshme mirëpo nuk garantojnë saktësinë dhe tërësinë e tyre. Informatat janë dhënë pa obligim dhe në kuptimin se çdo person i cili vepron apo përndryshe ndryshon qëndrimin e tij/saj duhet t'a bartë vetë rrezikun për këtë.

Projekt aktet ligjore pa politika legjislativ dhe pa vlerësime paraprake, një forme e ndikimit të nivelin e ulet të sundimit të ligjit në Kosovë

Kujtim Kërveshi, Këshillëtar i lartë ligjor i Ministrisë të drejtësisë



Pas themelimit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë janë propozuar dhe përpiluar qindra akte normative të përgjithshme. Shumë nga këto i janë nënshtruar një kontrolli të thellë të përmbajtjes së tyre nga ana e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut para se ato projekt akte të publikoheshin. Shumë nga aktet e propozuara edhe sot e kësaj dite gjenden në sirtarët e kësaj zyreje. Fillimisht duhet thënë se juristet dhe ekspertët tjerë vendorë si dhe projekte të shumta që kanë shpenzuar më miliona euro kanë ndihmuar Qeverinë dhe Kuvendin e Kosovës në përpilimin e projekt ligjeve nga fushat e përgjegjësive që kanë institucionet tona. Gjatë gjithë këtyre viteve, institucionet tona kanë përpiluar dhe miratuar projekt-akte nga më të ndryshmet, shumë nga të cilat nuk zbatohen dhe si të tilla kanë ndikim të drejtpërdrejtë në nivelin e ulët të sundimit të ligjit.

Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2005/15 dhe Rregullorja e Punës së Qeverisë 2005/1, ka përcaktuar se Zyra për Shërbime dhe Ndihmë Juridike

(“ZSHNJ”) brenda Zyrës së Kryeministrit (“ZKM”) rishikon tërë legjislacionin i cili i dorëzohet Kuvendit. Ndërsa propozim aktet ligjore propozohen si nga linjat ministrore po ashtu edhe nga vet ZSHNJ/ZKM. Megjithatë, Kuvendi i Kosovës është organi më i lartë legjislativ në vend - përgjegjësi kjo që buron nga Korniza Kushtetuese e Kosovës.

Përpilimi (vetëm të shkruarit e dispozitave) të një projekt akti ligjor është faza më e lehtë. Vështirësitë vërehen atëherë kur ai projekt akt ligjor duhet të vihet në jetë (të zbatohet), sidomos në rastin tonë ku nuk përpilohen politika legjislativ dhe nuk bëhet studim të ndikimit të atij projekt akti legjislativ. Bashkimi Evropian, ashtu siç tregojnë praktikatat e vendeve të sapo integruara në të, vëmendjen kryesore e orienton pikërisht në zbatimin e ligjit e jo në kuantitetin e tij. Nëse përpilimi i legjislacionit varet nga forma e jo përmbajtja dhe kur politika legjislativ nuk zë vend fare, cili mund të jetë rezultati i atij projekti akti ligjor? Një projekt akt i tillë është i përcaktuar të mos zbatohet ose të zbatohet si i çalë siç edhe ndodhë në rastin tonë.

Për të garantuar suksesin e një projekt-akti ligjor duhet të sigurohen mjetet buxhetore. Planifikimi i këtyre shpenzimeve nuk mund të behet mbi baza ad hoc, por në bazë të një parashikimi paraprak të detajuar lidhur me koston buxhetore

që nevojitet për zbatimin e një projekt-akti ligjor, në veçanti para se të filloj vet përpilimi i atij projekt akti. Përndryshe, në vendin tonë ne humbasim kohë, energji dhe kapacitetet humane duke i shfrytëzuar ato gabimisht sepse i gabuar është mekanizmi i cili është vendosur atëherë kur edhe janë themeluar institucionet tona. Fenomeni që po analizojmë në këtë shkrim është një fenomen që ka buruar që nga themelimi i institucioneve, i ka përcijellur të gjitha Qeveritë të cilat kanë marrë mandatin nga Kuvendi si dhe Kuvendi nga fillimi e deri tani vazhdon me të njëjtën mënyre të aprovimit të ligjeve përkundër mangësive të lartë cekura.

Për më tepër, duhet pranuar faktin se qytetarët i besojnë një procesi dhe një institucioni nëse ai proces dhe ai institucion janë transparent në veprimet e tyre. Institucionet të cilat përpilojnë projekt aktet ligjore e deri te ato që ekzekutojnë vendimet e gjykatave me mjete të dhunës, sa i përket transparencës në punë në këtë fushë nuk duken të jenë transparente.

Në rastin tonë, janë të rralla ato projekt akte të cilat përshkohen me një transparencë të mjaftueshme dhe ku qytetari dhe grupet e interesit madje edhe vet përfaqësuesit e institucioneve janë të informuar me përmbajtjen dhe marrëdhëniet shoqërore që ai projekt-akti ligjor do t'i rregulloj.

Kur ligji përpilohet, në veçanti pa zhvillimin e politikave, përmbajtja e tij nuk përfshin për se edhe qëndrimet e vendimmarrësve. Pa zhvillimin e politikave legjislativ, ekziston rreziku i përhershëm i përpilimit të ndonjë legjislacioni i cili mund: të mos jetë i nevojshëm, mund të përpilohet projekt-akti i cili përmban probleme serioze për zbatimin e tij dhe si të tillë e rëndojnë punën e sistemit gjyqësor dhe sundimin e ligjit si dhe në përgjithësi rëndon sigurinë juridike.

Mungesa e zhvillimit serioz të politikave vepruese legjislativ në institucionet tona për momentin e bën procesin e konsultimit ndër-institucional të pamundshëm. Si pasojë e këtij mos komunikimi, ndodhin raste nga më të çuditshmet, kur dy institute ligjore rregullohen në dy forma të ndryshme nga dy institucione. Nëse si të tilla miratohen dhe shpallen ato ligje që në përmbajtjen e tyre kanë kësi lloj mangësish, qytetari i Kosovës do të ketë probleme me të gëzuarit e të drejtave të garantuara me ligj sepse në njërin parashikohet ndryshe, e në tjetrin ndryshe. Kosova ka nevojë ta zbatoj rregullin e dispozitës së qartë, pa kushte dhe drejtpërdrejtë në çështje.

Institucionet tona miratojnë “agjenda legjislativ” (ky proces nuk hartohet brenda orësh siç është thënë nga autor të tjerë) të cilat i ngjasojnë më tepër listave dëshirore ku rallë

herë mund të jipet përgjigje e sakët se çka në fakt mendohet të rregullohet me përmbajtjen atij projekt akti. E vetmja gjë që dihet zakonisht janë titujt e ligjeve dhe më vonë janë vërejtur edhe mangësi të atilla se titulli i ligjit nuk reflekton përmbajtjen e tij. Në vend se titulli të jetë i përcaktuar nga vet korniza që do të duhet të përcaktohet nga një politikë legjislative e miratuar, në sistemin tonë ndodhë pikërisht e kundërta. Aspak më mirë nuk qëndrojnë edhe shumica e vendeve të rajonit tonë. Edhe në rajonin tonë përpilohet projekt-akte ad-hoc dhe me mangësi të mëdha. Andaj, duhet menduar a i duhet fare Qeverisë “agjenda legjislative” dhe a duhet Kuvendi ta përcielle këtë listë? Praktika ka treguar se që nga themelimi i institucioneve kjo mënyrë e punë nuk ka funksionuar.

Përveç kësaj që u tha më lartë dhe që përgjegjës është kryesisht ekzekutivi jonë, edhe Kuvendi jonë nuk merr për bazë fare projekt ligjet të cilat tentojnë përafrimin e legjislacionit të BE-së me atë vendor. Tek ne trajtohen njëjtë si ato ligje që nuk kanë të bëjnë fare me Acquis e BE-së si ato që janë drejtpërdrejtë të varura nga kjo tërësi e normave të Bashkimit Evropian. Duhet shtruar ketë çështje si një nder më të rëndësishmet në të ardhmen dhe një bashkëpunim ndër-institucio-

nal është i domosdoshëm për vet procesin të cilin Kosova do ta ndjek dhe për funksionalitetin e vet Kuvendit të Kosovës në miratimin e ligjeve sistemore të Kosovës.

Përfundimisht, krijohet përshypja se institucionet tona nuk kanë mundësi të përmirësojnë këtë gjendje për shkak të mungesës së kapaciteteve humane. Një numër shumë i madh i zyrtarëve ligjor punon në përpilimin e projekt-akteve ligjore, mirëpo janë të pakët ata të cilët konsultojnë materiale në gjuhët zyrtare të BE-së dhe se nga kjo janë në gjendje të bëjnë përafrimin e legjislacionit vendor me atë të BE-së dhe me praktikat më të mira ndërkombëtare, të pakët janë gjithashtu ata të cilët kanë teknika të bukura të shkrimit ligjor, të të menduarit ligjor dhe të arsyetimit.

Përfundimisht, gjithë këtë proces shkurtimisht do të mund ta definonim si një problem me të cilin ballafaqohen institucionet tona të cilat bëjnë përpilimin e legjislacionit të cilin e përshkojnë: mungesa e ideve të mjaftueshme, mungesa e vlerësimit adekuat dhe e zbatimit të dobët të legjislacionit në Kosovë që në një formë buron nga mosplanifikimi dhe përcaktimi i duhur si dhe nga vet niveli i ulët profesional në të gjitha institucionet të cilat e zbatojnë ligjin.



Këshilltarja e re e OSBE-së për Kryetarin e Kuvendit



Më 17 janar 2007 këshilltarja e re e lartë e OSBE-së për Kryetarin e Kuvendit Zonja Liia Hanni, ka marrë përsipër përgjegjësitë e saj. Zonja Liia Hanni është një ish parlamentare e Republikës së Estonisë. Nga viti 1990 deri në vitin 1992 ajo ishte anëtare e Këshillit Suprem (parlamentit kalimtar), anëtare e Kongresit të Estonisë dhe anëtare e Asamblesë Kushtetuese. Nga viti 1992 deri në vitin 1995 ajo ka qenë ministre në qeverinë e

Estonisë përgjegjëse për privatizim dhe kryesuese e Bordit të Agjencisë së Privatizimit. Nga viti 1995 deri në vitin 2003 ajo ka qenë deputete e parlamentit dhe kryesuese e Komitetit Kushtetues (1999 -2002) dhe nënkryesuese e Komisionit Parlamentar të përbashkët Estoni-BE që ka marrë pjesë në konsultimet e Konventës Kushtetuese Evropiane. Kohëve të fundit ajo ka punuar si drejtoreshë e programit “qeverisja elektronike” që është përgjegjëse për zhvillimin e programeve të demokracisë elektronike në Estoni. Duke qenë pjesë e Zyrës së Kryetarit të Kuvendit, Zonja Liia Hanni do të bashkëveprojë me këshilltarin e NDI/USAID për Kryetarin e Kuvendit dhe projektin e financuar të BE-së për Kuvendin

Raporti i ri për zbatimin e ligjeve të Kuvendit të Kosovës

Më 26 janar 2007, Misioni i OSBE-së ka nxori raportin e tretë për zbatimin e ligjeve të Kuvendit të Kosovës nga dega ekzekutive e Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ) në Kosovë. Në të njëjtën ditë ishte mbajtur edhe konferenca për shtyp në të cilën shefi i Misionit dhe përfaqësuesit e Departamentit për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimit të Ligjit prezantuan raportin. Synimi parësor i raportit është që të analizojë nivelin deri në të cilin ligjet e miratuara nga Kuvendi i Kosovës janë duke u zbatuar nëpërmjet të legjislacionit sekondar. Fushëveprimi kryesor përfshin ligjet e Kuvendit të miratuara në vitin 2005 mirëpo gjithashtu përfshin aktivitetet përcjellëse nga dy raportet e kaluara që mbulojnë periudhën 2002 - 2004. Raporti gjithashtu trajton çështjet të cilat ndërlidhen me zbatimin e ligjeve siç janë botimi i ligjeve, hierarkia e ligjeve, hartimi i ligjeve dhe mbikëqyrja parlamentare.

Ligjet pa politika

Ilir Dugolli,

Ish këshillëtar i lartë politik i Kryeministrit të Kosovës dhe aktualisht hulumtues në Institutin kosovar për hulumtim të politikave dhe zhvillim (KIPRED)



Politikat e mangëta rrjedhojnë me ligje të mangëta. Ligjet e mangëta në anën tjetër, sjellin deri të vendimet, politikat dhe veprimet e gjymta. Por, ligjet pa politika fare janë edhe më të mangëta. Përderisa në të kaluarën, politikat e miratuara nga partia u liheshin juristëve për t'u kodifikuar në gjuhën juridike, sot barra mbi supet e juristëve është shumë më e rëndë. Juristët tani e bëjnë të njëjtën punë si më parë, por pa ndonjë udhëzues të politikave publike apo me një apo dy fjalë udhëzimi nga ministri. Me këtë nuk mbarojnë të metat e sistemit të tanishëm të përgatitjes së ligjeve.

Një e metë thelbësore e sistemit të tanishëm të përgatitjes së ligjet është se brenda ministrive po mungon bërja e politikave, sidomos analiza e tyre, si dhe diskutimi gjithëpërfshirës i tyre. Juristët, në të shumtën e rasteve, fillojnë punën nga zeroja, pa udhëzimet e domosdoshme për punën që duhet të bëjnë.

Prioritet legjislativ po bëhen në mënyrë mekanike, të pamenduar mirë, pa analizën e nevojshme dhe në nguti. Mbështetur në propozime që të shumtën nxiten nga vlerësime subjektive, bëhet përpjekje bujare për të përfshirë të gjitha propozimet në agjendë legjislativ. Në këtë mënyrë, agjenda qëndron e shkëputur nga vlerësimet kri-

tike dhe nevojat e mirëfillta. Propozimet për të bërë ligje të reja nuk trajtohen në mënyrë kritike e as që ka përpjekje të mirëfilltë për prioritetimin e tyre.

Një e metë tjetër që lidhet me agjendën legjislativ ka të bëjë me mungesën e fleksibilitetit në qasjen ndaj saj. Në vend se të trajtohet si dokument udhëzues për ministritë (edhe atëherë kur supozohet se është formuluar si duhet), ajo shihet si dokument i ngurtë të cilës ministritë janë të detyruara t'i përmbahen. Në shumicën e rasteve, një ministri, nëse bin-det se përfshirja e ndonjë ligji në agjendë legjislativ është e paarsyeshme ajo mund ta injorojë detyrën e vet ose të kundërshtoj vendimin e qeverisë dhe ta bëjë tërë procesin e agjendës legjislativ që të duket si i pavlerë. Në rastin më të keq, kjo mund të sjellë deri tek përgatitja e projektligjeve të panevojshme dhe të dëmshme.

Tutje, ka mungesë tejet të madhe të vëmendjes në formulim të politikave. Mungon analiza e politikave e cila duhet ta ushqejë ligjin para se ky i fundit të miratohet. Ka mungesë të ndarjes së përgjegjësisë ndër-mjet rrolit të analistëve (qoftë të emëruar politik, shërbyes civil, apo të kontraktuar) në formulim të politikave, dhe rrolit të juristëve në shndërrim të politikave publike në gjuhë juridike. Në shumë raste mungon analiza e mirëfilltë e pasojave buxhetore të projektligjeve.

Është i shpeshtë kopjimi mekanik, qoftë nga një shembull apo, edhe më keq, nga modele të ndryshme duke bërë modele jofunksionale, të panatyrshme dhe kundërthënëse. Për më tepër, mungon zbatimi i mirë-

fillitë i ligjeve të miratuara dhe monitorimi i efekteve të tyre. Ka preokupim të shtuar në numër të madh të ligjeve, dhe matje të suksesit të ministrive me numrin e projektligjeve të përgatitura, gjë që krijon presion të shtuar për të bërë sa më shumë ligje, pa i kushtuar vëmendjen e domosdoshme cilësisë së tyre.

Nuk merren parasysh alternativat e ligjëvënies. Nuk mendohet sa duhet për faktin se ekzistojnë një numër i mjeteve të politikave publike që mund të përdoren për të trajtuar një problem pa pasur fare nevojë që të bëhet ligji. Hartimi i ligjet është vetëm një nga mundësitë e shumta për të arritur objektivat e politikave të qeverisë dhe ligjet duhet të përdoren vetëm kur janë më efektiv sesa mekanizmat tjerë më të arsyeshëm nga pikëpamja e çmimit.

Hartimi i legjislationit është detyrë për ekspertë ligjor më të avancuar sesa zakonisht mendohet në Kosovë. Kjo nuk është një punë që mund të kryhet nga cilido jurist, sepse aftësitë e nevojshme për të shndërruar politikat në norma juridike të detyrueshme nuk ftohen vetëm përmes fakultetit juridik apo përmes praktikave të zakonshme juridike. Hartimi ligjor është një aftësi e specializuar që kërkon shkathtësi të veçantë dhe përvojë relevante (teknikë shkrimi të përpiktë, njohuri të të gjitha ligjeve relevante, njohje të gjasave të zbatimit, aftësi përdorimi të gjuhës e mbi të gjitha njohje të teknikave dhe traditave ligjore si në mënyrë teorike ashtu edhe në atë krahasimore.

Në mënyrë që të përmirësohen disa nga të metat e tanishme të procesit të përgatitjes së pro-

jektligjeve një varg masash qëndrojnë në dispozicion. Në radhë të parë duhet riformuluar procesin nga i cili burojnë ligjet, në mënyrë që fillimisht të ketë përgatitje të opsioneve të politikave ("punimi i gjelbër"), të pasuar nga vendimi për politikat ("punimi i bardhë"), konsultimet e mirëfillta dhe vendosja për politikat e veprimit, dhe në fund hartimi ligjor si i tillë.

Gjithashtu, procesi i formimit dhe ripërpunimit të agjendës legjislativ duhet të përmirësohet. Agjenda legjislativ nuk duhet të hartohet brenda disa orëve, pa qasje kritike dhe ajo duhet të jetë elastike. Mbi themelet e një agjende legjislativ të përshtatshme, e cila vazhdimisht freskohet dhe ripërpunohet, ministritë duhet të zhvillojnë kapacitete të rëndësishme të politik-bërjes për të siguruar arritjen e konsensusit të nevojshëm përpara hartimit të projektligjeve. Duhet pasur parasysh se përgatitja e projektligjeve nuk është punë e juristëve të rëndomtë që punojnë brenda ministrive të ndryshme, por e një institucioni të veçantë e qendror i cili do të bënte shndërrimin në tekste ligjore të politikave të krijuara nëpër ministri.

Gjithsesi duhet pasur parasysh që shumë nga këto ndryshime nuk janë detyrë e lehtë dhe se pasojat, më pak të natyrës buxhetore sesa të tjerat, nënkuptojnë ndryshime konceptuale të qëndrimeve ndaj qëllimeve shoqërore që synohen të arrihen si dhe qasjes drejt tyre përmes ligjeve.

Ky shkrim është version i përshtatur i përmbledhjes ekzekutive të punimit të KIPRED-it "Ligjet pa politika – të papërdorshme, të pazbatueshme dhe të kota"

Transparenca:

Përmirësimi i procedurave parlamentare dhe informimi i deputetëve

Dale E. Archer, Këshilltar Legjislativ për Kuvendin e Kosovës



trans-par-en-cy –emër.

1. Gjithashtu, **trans-par-ence**. Cilësia dhe gjendja e të genit transparent.
2. Diçka transparente, posaçërisht pikturë, dizajn apo të ngjashme në xham apo substancë tjetër të tejdukshme, që ndriçohet nga drita depërtuese.¹

Ç'është transparenca? Kjo është një çështje sfiduese akoma më e vështirë për t'a sqaruar apo përshkruar. Në vitin 1964, Gjykata Supreme e Drejtësisë në SHBA Justice Potter Stewart u përpoq që t'a përshkruajë me një tjetër çështje po aq sfiduese të së folmes së lirë – pahijshmëria. Gjykatësi Stjuart tha, "Unë nuk do të provojë të definojë ato lloje materialesh që i kam adoptuar...Por do të di të definojë kur t'i shoh, dhe filmi në këtë rast këtu nuk është ai."²

Si duket transparenca? Si çdo

sfidë konceptuale, ne kërkojmë shembuj për t'u pajtuar apo mos u pajtuar mbi atë se ç'është transparenca, apo edhe çfarë nuk është transparenca. Rregullorja e Punës së Kuvendit të Kosovës është një përpjekje për të adresuar transparencën në Kuvendin e Kosovës. Rregulla 65 adopton Shtojcën Nr. 1 që përmban Rregullën 1(e). Kjo Rregull thotë që "Deputetët do të jenë sa më të hapur për të gjitha veprimet dhe vendimet që ndërmarrin. Ata do të arsyetojnë vendimet e tyre dhe të kufizojnë informacionin vetëm nëse opinioni i gjerë publik qartazi kërkon një gjë të tillë." Rregulla 1(d), gjithashtu në Shtojca Nr. 1, aludon në transparencë: "Deputetët janë përgjegjës për vendimet e tyre dhe i nënshtrohen një vetëkontrolli të kujdesshëm që i përgjigjet funksionit të tyre."³ Kësisoj, duket sikur vendimet dhe veprimet e deputetëve konfirmojnë transparencën. A do të jetë ky vendim transparent? A ishte veprimi i hapur për shqyrtim? A do të jetë transparent një dëgjim i mbyllur i komisionit? Nëse vlen definicioni i mësipërm atëherë nënkuptohet që veprimet dhe vendimet duhet të jenë transparente për të dëshmuar transparencë.

Instituti Nacional Demokratik (NDI) në bashkëpunim me partnerët e Iniciativës për Mbështetje Kuvendit (ASI), i kanë ndihmuar Kuvendit për të bërë Planin e Standardeve të Kuvendit (ASP) në vitin 2006 që është miratuar nga Kuvendi

në qershor. PSK ka theksuar disa elemente që do të fuqizonin transparencën e Kuvendit, përfshirë këtu agjendën, (Rregulla 23), interpelanca (Rregulla 25), dhe periudha e pyetjeve (Rregulla 26). Këto ndryshime kanë përmirësuar eficiencën dhe proceseve aq të rëndësishme të Kuvendit. Këto amendamente ka qartësuar dhe trasuar mënyrën e përcaktimit të agjendës nga ana e deputetëve, planifikimin e interpelancës, përfshirë edhe kufijtë kohor, mënyrën e organizimit të pyetjeve posaçërisht shtojcat e periudhës për pyetje për të gjitha agjendat e seancave plenare. Përkundër përmirësimeve në rolin e mbikëqyrjes së ekzekutivit, deputetëve akoma ju mungon informacioni i rregulltë për punën e Kuvendit.

Rregullorja e Punës e Kuvendit të Kosovës u garanton deputetëve të drejtën për informim. Në Rregullën 1.1(d) dhe Rregullën 8.1 të Shtojcës 2 të Rregullores, "Çdo deputet ka të drejtën për t'u informuar mbi punën e Kuvendit dhe të shprehë mendimin e tij/saj mbi çështjet e caktuara. Këto mendime mund të ju shprehën Kryesuesve të Kuvendit në mënyrë të drejtpërdrejtë apo përmes pyetjeve në seancat për debate në Kuvend."⁴ Kjo Rregull u garanton deputetëve informimin. Por kjo ngrit pyetjen tjetër se me çfarë mekanizmi realizojnë deputetët të drejtën për informim të rregulltë? Si do të dinë deputetët sesa projektligje,

mocione, rezoluta, deklarata dhe pyetje për Qeverinë kanë mbetur pezull dhe të pazgjdhura nga Kuvendi? Si do të dinë deputetët se kur janë dorëzuar raportet e komisioneve për shqyrtim dhe debat në Kuvend? Si do të dinë deputetët se kur të jenë dorëzuar raportet e Qeverisë në Kuvend? Rregullorja e Punës për momentin nuk ofron ndonjë mekanizëm të rregulltë që deputetët do të mund të ushtronin të drejtën për informim. Kjo "e drejtë" është e ngjashme sikur të ju garantohet deputetëve qasja në internet pa patur rrjetë, modem apo kompjuterë për të mundësuar qasjen në internet.

Parlamentet dhe ligjvënësit tjerë botojnë ato çfarë quhen dokumentet e porositura. Këto botime njihen edhe si kalendare të punës, detyra të ditës apo edhe magazina. Ndryshime të vogla në Rregulloren e Punës do të mundësonte botimin e dokumentit të porositiv për Kuvendin. Ky dokument do t'u ofronte deputetëve informatat tjera që nuk ua ofron Rregullorja e Punës. Botimi i informatave të Kuvendit⁵ në mënyrë të rregulltë do të përmirësonte dukshëm transparencën e Kuvendit. Dokumenti i Porositiv do të mund të definonte më mirë punën e Kuvendit dhe të jetë një mekanizëm transparent për informim.

Një tjetër referencë në Rregullën 8.1 të Shtojca 2 thotë, "Çdo deputet i Kuvendit e

ka të drejtën ...për të shprehur opinionet për çështje të caktuara.”⁶ Si mund të realizohet një gjë e tillë pa qenë i kufizuar me elemente të caktuara të agjendës? Si do t'i shprehin deputetët mendimet e tyre që nuk janë të ndërlidhura me mocione dhe projektligje të caktuara? Rregullorja u mundëson Ministrave të Qeverisë për të bërë deklarata gjatë çdo seance plenare të Kuvendit.⁷ Rregulla 28 për deklaratat e Ministrave ngrit

pyetjen – pse Ministrave gjithashtu nuk iu garantohej një mekanizëm përmes së cilës do të mund të shprehnin të drejtën për dhënien e mendimeve në çështje të caktuara? Rregullorja e Punës së Kuvendit nuk ndanë kohë për deputetët dhe as për grupet parlamentare që të bëjnë deklaratat. Një tjetër ndryshim i vogël në Rregullore do të mund të garantonte edhe kohën e rezervuar në agjendën e deputetëve dhe grupeve parlamentare për

të shprehur mendimet e tyre gjatë seanceve plenare

Me elaborimin e çështjes së transparencës, do të mund të miratoheshin mekanizma të tjerë të mundshme të transparencës në kuadër të Rregullores së Punës. Dhe rezultatet e vetme kuantitative do të jenë hapja e proceseve procedurale dhe të politikë-bërjes të Kuvendit dhe të sigurojë që veprimet dhe vendimet e deputetëve janë transparente përballë elektoratit, opinionit

publik dhe mediave. Transparenca vështirë përshkruhet apo definohet, por siç e tha edhe Gjykatësi Stjuart – *ne do t'a njohim/dallojmë posa t'a shohim të jetë realizuar.*

Dale E. Archer punon si Këshilltar Legjislativ i NDI në Kuvendin e Kosovës. Ai më parë ka punuar si ndërlidhës për ligjvënësit dhe ekzekutivët e lartë në parlamentin shtetëror në SHBA si dhe ka shërbyer në një numër fushatash politike.



¹ *Dictionary.com Unabridged (v 1.1), Based on the Random House Unabridged Dictionary, Random House, Inc. 2006.*

² *Jacobellis v. Ohio, 378 U.S. 184, 197 (1964)*

³ *Kuvendi i Kosovës, Rregullorja e Punës, e miratuar më 20 maj, 2005, amendamentuar më 1 qershor, 2006; Rregullat 1(e)-(d) të Shtojca 1 nga Rregulla 65*

⁴ *Kuvendi i Kosovës, Rregullorja e Punës, e miratuar më 20 maj, 2005, amendamentuar më 1 qershor, 2006; Rregulla 8.1 të Shtojca II nga Rregulla 65*

⁵ *Kuvendi i Kosovës, Rregullorja e Punës, e miratuar më 20 maj, 2005, amendamentuar më 1 qershor, 2006; Rregullat 8.1 të Shtojca II nga Rregulla 65*

⁶ *Kuvendi i Kosovës, Rregullorja e Punës, e miratuar më 20 maj, 2005, amendamentuar më 1 qershor, 2006; Rregullat 8.1 të Shtojca II nga Rregulla 65*

⁷ *Kuvendi i Kosovës, Rregullorja e Punës, e miratuar më 20 maj, 2005, amendamentuar më 1 qershor, 2006; Rregulla 28 Deklaratat e Ministrave*

Rrugë e gjatë deri në emërimin e Ombudspersonit

Floriana Shala, Monitoruese e Kuvendit, Misioni i OSBE-së në Kosovë



Në fillim të vitit 2006, pas konsultimit me Kuvendin e Kosovës dhe Qeverinë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) i Kombeve të Bashkuara në Kosovë e dorëzoi kompetencën për vazhdimin e funksionimit të Institucionit të Ombudspersonit. Rregullorja 2006/6, si rrjedhim ia garanton të drejtën Kuvendit të Kosovës që ta bëjë emërimin e Ombudspersonit dhe Zëvendësit të parë të Ombudspersonit, si dhe tre Zëvendës tjerë të Ombudspersonit.

Në bazë të nxjerrjes së rregullores së lartpërmendur, Kuvendi i Kosovës, respektivisht Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativ dhe kornizë kushtetuese (në tekstin e mëtejme Komisioni Legjislativ) në bashkëpunim me Departamentin për të Drejtat e Njeriut dhe Sundimin e Ligjit pranë OSBE-së, hartuan Rregulloren e Punës mbi zgjedhjen e Ombudspersonit dhe Zëvendësin e parë të Ombudspersonit, e cila është miratuar në Kuvend më 15 qershor, 2006.

Komisioni Legjislativ formoi

një panel, ku përfaqësohet secili grup parlamentar për përgjegjësitë ndaj procesit të rekrutimit. Paneli ka intervistuar me profesionalizëm të lartë 19 aplikues për pozitën e Ombudspersonit dhe Zëvendësin e parë të Ombudspersonit. Pas fazës së intervistimit, paneli i propozoi Kuvendit, në pajtim me rregullat e miratuara më parë, nga tre kandidatët për të dy pozitën. Kandidatët për pozitën e Ombudspersonit ishin z. Hilmi Jashari, ushtruesi i tanishëm i detyrës së Ombudspersonit të Kosovës, z. Ibrahim Makolli dhe znj. Diana Toska, përderisa kandidatët për Zëvendësin e parë të Ombudspersonit ishin z. Ljubinko Todorovic, Zëvendës Ombudspersoni i tanishëm, z. Habit Hajredini dhe z. Pal Bala.

Në seancën plenare të 17 nëntorit, z. Sadudin Berisha, zëvendës kryesuesi i parë i Komisionit Legjislativ i raportoi Kuvendit lidhur me procesin e rekrutimit dhe procedurën e zgjedhjes së Ombudspersonit dhe Zëvendësit të parë të Ombudspersonit, duke shpjeguar, që duhet të bëhen dy zgjedhje me vota të fshehta dhe nëse asnjëri prej kandidatëve nuk e merr shumicën absolute të votave në të dy raundet, atëherë duhet të përsëritet konkursi. Më vonë, znj. Zlatica Kujundjic, anëtare e Partisë Demokratike Serbe (SDS), kërkoi nga Kuvendi që ta shtyjë zgjedhjen e Zëvendësit të parë të Ombudspersonit, në mënyrë që atyre tu

jepet më shumë kohë për konsultime. Sidoqoftë, Kuvendi i shtyri të dy emërimet shkaku i bojkotimit të partisë më të madhe opozitare në seancën plenare.

Në seancën plenare të 14 dhjetorit, Kuvendi votoi në dy raunde, me vota të fshehta për emërimet në fjalë, por asnjëri prej kandidatëve nuk ka fituar shumicën absolute të votave në asnjërin prej dy rraundeve. Pas shpalljes së rezultateve, u ngrit diskutimi lidhur me numrin e nevojshëm të votave, në mënyrë që të jenë valide emërimet. Së këndejmi, disa deputetë të Kuvendit theksuan, që ka patur diskrepancë ndërmjet Rregullores 2006/6 të UNMIK-ut dhe Rregullave të Kuvendit. Seksioni 6.2 i rregullores së UNMIK parashihet që Ombudspersoni dhe Zëvendësi i parë i Ombudspersonit do të zgjidhen me vota një nga një, duke e pasur mbështetjen e shumicës së deputetëve të Kuvendit, që do të thotë së paku 61 vota. Në anën tjetër, Rregullat e Kuvendit parashohin që Ombudspersoni dhe Zëvendësi i parë i Ombudspersonit do të zgjidhen me shumicën e deputetëve prezentë dhe me votim. Kështu që, Kuvendi vendosi ta qartësojë këtë çështje me Zyrën e UNMIK-ut për Çështje Ligjore.

Më 9 janar, PSSP-ja i dërgoi një letër Kryetarit të Kuvendit duke thënë se "votimi i cili zuri vend më 14 dhjetor për zgjedhjen e Ombudspersonit dhe Zëvendësit të parë

të Ombudspersonit nuk mund të konsiderohet si definitiv, meqë shumica e votave të kërkuara për zgjedhjen e kandidatëve nuk është arritur tek efektiv." Veç tjerash, shkresa sugjeronte që "Kuvendi duhet ta . . . përsëris votimin me kandidatët e propozuar nga Komisioni Legjislativ derisa të plotësohet kërkesa për shumicën absolute të votave."

Në seancën plenare, më 11 janar, kryesuesi z. Xhavit Haliti (PDK) e njoftoi Kuvendin që Kryesia kishte propozuar rishpalljen e konkursit për të dy pozitën, para se ta merrnin shkresën e PSSP-së, meqë letra e parë e dërguar nga kryesuesi i zyrës për çështje ligjore pranë UNMIK-ut nuk ka bërë rekomandime që të merren hapa të mëtejshëm, pasi që rezultati i shpallur ishte jovalid. Vendimi i tillë nga Kryesia doli të jetë në kundërshtim me rekomandimet e bëra më vonë nga PSSP-ja për përsëritjen e votimit me të njëjtit së kandidatëve për pozitën e Ombudspersonit dhe Zëvendësit të parë të Ombudspersonit deri sa Kuvendi t'i bëhej interpretimi përfundimtar nga zyra e PSSP-së.

Përgatitja e interpretimit përfundimtar nga zyra e PSSP-së do t'ia mundësojë Kuvendit të merr hapa të mëtejshme në finalizimin e emërimeve për Ombudspersonin dhe Zëvendësin e parë të Ombudspersonit, me shpresë që në të ardhmen do të rezultojë me sukses, për dallim nga hera e parë.

Përkrahja për Kuvendin e Kosovës gjatë muajve: dhjetor 2006 dhe janar 2007

Franklin De Vrieze, Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Përkrahja për Komisionin Hetimor

Pas debatit në seancën plenare për raportin e Auditorit të Përgjithshëm për punën e Kuvendit më 3 nëntor 2006, Kuvendi ka krijuar një komision hetimor të kryesuar nga Dr. Ferid Agani dhe që përbëhet në mënyrë proporcionale nga të gjitha grupet parlamentare të Kuvendit. Kuvendi ka i ka vënë për detyrë komisionit që të përfundojë punën e vet deri më 31 janar 2007 dhe të dorëzojë një raport me rekomandime. Më 29 - 30 janar 2007, Komisioni Hetimor u mbledh për një udhëtim pune për të përfunduar raportin përfundimtar të komisionit. Gjatë këtyre dy ditëve, komisioni shqyrtoi draft raportin rresht për rresht duke ndërtuar një koncensus për konkluzionet përfundimtare. OSBE financoi dhe ndihmoi këtë takim pune të mbajtur në Mitrovicë. Komisioni ia dorëzoi raportin Kryesisë së Kuvendit më 9 shkurt 2007 në gjuhën shqipe dhe serbe. Përkthimi në gjuhën angleze është përgatitur nga IND dhe OSBE-ja.

Përfundimi i mandatit të komisionit u realizua pas dy muaj pune që përfshinte grumbullimin e dëshmimeve me shkrim dhe me gojë nga një numër i individëve të përzgjedhur. Edhe pse komisioni punoi pa kornizë ligjore për shkak se projekt ligji për komisionet hetimore ende është në miratim e sipër, më shumë se gjysma e individëve të kontaktuar dhanë përgjigjet e tyre përfshirë këtu edhe anëtarët e kryesisë së Kuvendit. Komisioni kishte punuar me Auditorin e Përgjithshëm për të kuptuar më mirë metodologjinë e tyre dhe procesin nëpërmjet të cilës ai kishte arritur deri tek përfundimet e veta. Komisioni gjithashtu punoi me prokurorin ndërkombëtar për të siguruar që puna e komisionit nuk ndërhyr në hetimet penale që janë në zhvillim e sipër. Kjo është hera e parë që komisioni hetimor në kuadër të Kuvendit të Kosovës kishte përmbushur mandatin e vet dhe komisioni do të ofrojë leksione të vlefshme të mësuara për ligjin mbi komisionet hetimore dhe për komisionet e ardhshme hetimore.

Përkrahja për Komisionin për Siguri

Si pjesë e përkrahjes së OSBE-së për Komisionin për Siguri, në Skuadër të komisionit parlamentar për siguri është formuar grupi punues për industrinë private të sigurisë. Në takimin e parë të grupit punues më 19 dhjetor 2006, anëtarët e Kuvendit diskutuan për gjetjet e konsulentit të OSBE-së për legjislativonin e sigurimit privat dhe drejtimin të cilin ligji në ardhmen duhet të merr. Ishte arritur pajtimi që të shqyrtohet përvoja e Bullgarisë, vend ky i cili e ka të rregulluar mirë sektorin e sigurimit privat gjatë katër viteve të kaluara në frymën e anëtarësimit në BE. Më 19 janar kryesuesi i komisionit për siguri mbledhi të gjitha organizatat ndërkombëtare dhe lokale të cilat ndihmojnë në punën e komisionit për të koordinuar përpilimin dhe rishikimin e draftit të planit vjetor të komisionit për vitin 2007. Pjesëmarrësit kanë përfshirë edhe Qendrën me seli në Gjenevë



për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (K DFA), konzorciumin e AER-it për katër parlamentet, KIPRED-i dhe OSBE-ja.

Përkrahja për Komisionin për Arsim

Nga 3 deri më 9 dhjetor 2006, OSBE-ja sponsoroi dhe organizoi një vizitë për komisionin e Kuvendit të Kosovës për Arsim në institucionet arsimore irlandeze në Dablin për t'i ndihmuar komisionit që të fitojë përvojë në sistemin ligjor dhe administrativ të kualifikimeve dhe sigurimit të cilësisë. Vizita ndihmoi punën e vazhdueshme në hartimin e ligjit për kualifikimet dhe për ndërtimin e kornizës kosovare për kualifikime. Më 24 janar 2007, OSBE-ja ka marrë pjesë në një takim të komisionit të Kuvendit për arsim që kishte për qëllim përkrahjen që OSBE-ja mund të japë për komisionin në finalizimin e draft ligjit për kualifikime.

Përkrahja e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve

Delegacioni i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve (KDIK) së bashku me stafin ligjor të Kuvendit vizitoi Strasburgun prej 19 dhjetor deri më 22 dhjetor 2006 dhe u takua me bashkëbisedues të ndryshëm të cilët trajtuan zbatimin e Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, gjendjen e tanishme dhe respektimin e të drejtave të njeriut, angazhimin e institucioneve evropiane në përgatitjen e kushtetutës së ardhshme të Kosovës, zbatimin e Kartës Sociale Evropiane dhe Kartës për Gjuhët e Pakicave dhe ato Regionale dhe çështjet që kanë të bëjnë me Komisionin Europian kundër Racizmit dhe mostolerancës. Kjo vizitë studimore ishte pjesë e projektit të OSBE-së për të siguruar një funksionim efikas të KDIK-në. Projekti gjithashtu ndihmon KDIK-në në përgatitjen e një numri të vizitave fushore në komunat anëmbanë Kosovës.



Përkrahja për grupet parlamentare

Raundi i tretë i programeve të praktikantëve me grupet parlamentare ka filluar më 2 tetor 2006 dhe ka zgjatur deri në fund të vitit. Grupi i tretë i studentëve praktikantë ka organizuar konferenca në temat që janë me interes për grupet parlamentare krahas dhënies së mbështetjes tjetër për grupet parlamentare. Më 11 dhjetor 2006, Grupi Parlamentar i PDK-së ka mbajtur një konferencë mbi temën “për çfarë sistemi zgjedhor ka nevojë Kosova”. Më 15 dhjetor 2006, grupi parlamentar ORA kishte mbajtur një konferencë për “planin e veprimit rinor dhe fuqizimin e rinisë”. Më 18 dhjetor 2006, grupet parlamentare për integrim kishte organizuar një konferencë për pakicat dhe mediat. Më 19 dhjetor 2006, grupi parlamentar i AAK-së kishte mbajtur një konferencë për arsimin e lartë. Më 22 dhjetor 2006, grupi parlamentar i LDK-së kishte organizuar një konferencë për integrimin e grupeve të marginalizuara në kuadër të shoqërisë. Konferencat përbënin mbylljen e raundit të tretë të programit të praktikantëve. Raundi i katërt filloi më 1 shkurt 2007. Studentët praktikantë janë duke ndihmuar të gjitha grupet parlamentare si dhe për herë të parë edhe grupin parlamentar të grave. Ky projekt është një pjesë e rëndësishme e përkrahjes së OSBE-së për të forcuar grupet parlamentare projekt ky i cili ka filluar në vitin 2005. Bashkëveprimi dhe bashkëpunimi i rregullt është organizuar nga studentët praktikantë të NDI-së të cilët janë duke punuar për komisionet parlamentare të kuvendit dhe sekretariatit.

Përkrahja njësisë së dokumentimit dhe bibliotekarisë

Kuvendi i Kosovës, Biblioteka Kombëtare dhe Universitare dhe Projekti i financuar nga BE-ja “Përkrahja e Mëtejme për Kuvendin e Kosovës” kanë filluar një bashkëpunim të përbashkët për themelimin e një njësie funksionale bibliotekare dhe të dokumentimit në Kuvendin e Kosovës. Më 9 janar 2007, Zotëri. Kolë Berisha, Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Dr. Sali Bashota, Drejtor i Bibliotekës Kombëtare dhe Zotëri. Hugues de Courtivron, udhëheqës i ekipit të projektit kanë nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit (MM) për të vendosur kushtet e këtij bashkëpunimi. MM-ja do të sigurojë Kuvendit trajnim profesional dhe konkret për bibliotekistët. MM-ja gjithashtu parashikon dhënien e përkrahjes për themelimin e qasjes në revistat

dhe magazinat ndërkombëtare si dhe në bazat e shënimeve. Mundësia për anëtarët dhe stafin për të marrë informata të sakta dhe shpejta nëpërmjet të shërbimit të bibliotekës dhe dokumentacionit do të përmirësojë aftësinë e Kuvendit të Kosovës për të shqyrtuar dhe ndryshuar ligjet si dhe për të mbikëqyruar degën e ekzekutivit.

Kryesisë së Kuvendit dhe Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim në BE vizitoi Parisin dhe Brukselin

Komisioni për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integrim në BE ka një detyrë tejet të ndërlidhur për të diskutuar politikatat e ndërlidhura me integrimin në BE në periudhën kur të gjithë sytë janë drejtuar kah statusi i ardhshëm i Kosovës. Përderisa Kuvendit i nevojitet të forcojë kapacitetet profesionale të deputetëve të kuvendit dhe nëpunësve civil të këtij komisioni, vizitat e punës në Bruksel dhe Paris janë mbajtur prej 14 deri më 19 janar 2007. Deputetët e Kuvendit të Kosovës janë takuar me homologët e tyre në Bruksel dhe Paris për të shkëmbyer mendimet për marrëdhëniet ndërmjet pushtetit legjislativ dhe ekzekutiv në përafrimin dhe harmonizimin e ligjeve dhe politikave me standardet e BE-së. E shoqëruar nga dy zyrtarë ligjor të sekretariatit të Kuvendit, deputetët kanë elaboruar çështjen e marrëdhënies ndërmjet të komisioneve të ndryshme të përhershme të parlamentit frëng dhe atij belg sa i përket standardeve të BE-së për legjislacionin dhe politikatat.



Nga 28 deri më 31 janar 2007 Kryetari i Kuvendit, anëtarët e Kryesisë së Kuvendit dhe Sekretari i Përgjithshëm kanë zhvilluar një vizitë pune në Paris. Gjatë diskutimeve me Presidentin e Asamblesë Kombëtare të Francës, parlamentarët dhe nëpunësit civil ishin përqendruar në menaxhimin e procesit legjislativ dhe më në veçanti në krijimin e agjendës në konsultim me qeverinë, kryesuesit e komisionit legjislativ dhe kryesuesit e grupeve parlamentare, menaxhimin e seancës plenare dhe rolin e kryesisë në zhvillimin e komunikimit institucional të Kuvendit me shoqërinë civile dhe zhvillimin e marrëdhënieve ndërkombëtare të Kuvendit. Të dyja vizitat studimore ishin organizuar nga projekti i financuar nga BE-ja “Përkrahja e Mëtejshme për Kuvendin e Kosovës” dhe Misioni i OSBE-së në Kosovë.

Deklarata e Misionit të ASI-t

Iniciativa për Mbështetje Kuvendit është një mekanizëm koordinues mes agjensioneve të ndryshme për programe demokratizimi në mbështetje të punës së Kuvendit të Kosovës si dhe fuqizimin dhe profesionalizimin e Kuvendit të Kosovës. Puna e ASI-t përqëndrohet në kulturën demokratike politike të bazuar në njohjen dhe respek-timin e rregullave demokratike të punës, transparencës dhe përgje-gjshmërisë ndaj opinionit publik, zhvillimit dhe implementimit të agjendës legislative, mbikëqyrjes mbi Ekzekutivin, respektin për shumëgjuhësinë dhe pjesëmarrjen në kontakte të ndryshme rajonale dhe ndërparlamentare.

Partnerët e ASI-t punojnë për të bashkuar resurset, shkëmbyer informacionin dhe koordinuar programet duke identifikuar nevojat në një interaksion të drejtëpërdrejtë me Kuvendin. Si koordinator i ASI-t Misioni i OSBE-së në Kosovë ndërldihet me gjithë partnerët e ASIT dhe fton në takime të rregullta koordinuese gjithnjë në konsultim dhe përfaqësuesit e Kuvendit. Buletini i rregullt i ASI-t informon publikun vendas dhe ndërkombtarë mbi zhvillimet në Kuvendin e Kosovës dhe programin mbështetës të ASI-t.

Anëtarët të tanishëm të ASI-t:

Friedrich Ebert Stiftung (FES), Friedrich Naumann Stiftung (FNSt.) Konrad Adenauer Stiftung (KAS), Projekti i Praktikave Parlamentare Lindje-Perëndim (EWPPP), Agjencioni Evropian për Rindërtim (AER) në bashkëpunim me Konzorciumin e parlamenteve të Francës, Gjermanisë, Belgjikës, Sllovenisë dhe Institutin për Mbrojtje të Parisit, Agjencioni Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtarë (USAID) në bashkëpunim me Institutin Nacional Demokratik (NDI), Programi Zhvillimor i KB-ve (UNDP) në bashkëpunim me Unionin Ndërparlamentar (IPU), Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Kuvendi i Kosovës.



Këshilli redaktues:

Sven Lindholm, Franklin De Vrieze, Skender Durmishi, Blerim Vela, Alfons Lentze, Ramë Manaj, Edmond Efendija, Krenar Loshi, Valdet Sadiku.

Redaktorët : Chris Cycmanick, Jennifer Ober, Leslie Hough, Nuno Luzio.

Grafika dhe faqosja: Shpend Kada

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt: franklin.devrieze@osce.org
http: / /www.osce.org/ kosovo

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetem atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij buletini :

OSBE-ja: 5, 8, 9, 11, 12, 13, 14, 16, 17, 23. Express: Astrit Ibrahim: 1, 2, 7, Fisnik Dobreci: 3, 10. Ermal Meta: 4. Chad Rogers: 21.